ISSN 1857-6443
9 771857 644006

Shkarkimet

Thellohet kriza, fillimi i fundit i VMRO-së

Fq.3

POLITIKAT E GJYQËSORIT

Pengesa ligjore për punë transparente

Fq.5

Angazhimi i futboll-istëve, vendimtar për fitoren

Fq.19

www.koha.mk

Koha

Nga njeriu i Merkelit te Salvini...

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3491 · e mërkurë, 24 tetor 2018 · 4°c | 18°c · 15 DEN

EDITORIAL

A janë shqiptarët viktimë të proceseve?



Qëndrimi politik i një partie, sa është i rëndësishëm për vetë atë, po aq, madje edhe më shumë, është i rëndësishëm edhe për opinionin publik. Janë të mirënjohura mënyrat e komunikimit politik dhe...

Fq.2

RAJON

Ligjet nuk funksionojnë për të pushtetshmit e politikës

Fq.12

FORUM

Ndarja e Evropës, Putinit mund t'i ngecë "sharra" në gozhdë

Fq.10

NDRYSHIMET KUSHTETUESE VETËM PËR MARRËVESHJEN E PRESPËS

S'KA VEND PËR KËRKESA ETNIKE!

Ndryshimet kushtetuese të iniciuara nga Qeveria e Maqedonisë, sipas ekspertëve juridik, për fat të keq nuk kane të bëjnë me të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe, por vetëm me ato burojnë nga Marrëveshja e Prespës si çështje e kontestit ndërshtetëror midis Maqedonisë dhe Greqisë. Madje, Denko Maleski thotë se nuk është ide e mençur që shqiptarët, në këtë kohë stresi për maqedonasit, të dorëzojnë edhe amendamente etnike

Fq.4

Nevojitet riadaptimi i tokave bujqësore

Shkup, 23 tetor - Prodhimtaria organike e ushqimit paraqet potencial të madh për zhvillimin e ekonomisë rurale në Maqedoni si dhe punësimin e fermerëve të rinj. Gjithashtu për dallim prej prodhimtarisë konvencionale si bujqësore ashtu edhe blegtorale, ajo nuk ka problem me shitjen dhe plasmanin e sigurt. Mirëpo, përkundër rritjes së interesimit për ushqimin organik nga Maqedonia në tregjet evropiane, që e dëshmojnë edhe shembuj të suksesshëm si grosha dhe kërpudhat organike që shiten në Zvicër prej vitit 2016, megjithatë vetëm 0.5 për qind e tokave bujqësore në Maqedoni janë të mbjella me prodhimtari organike. Kjo paraqet një sasi shumë të vogël në raport me mundësitë dhe kërkesat e tregut sidomos atij të huaj për një ushqim të shëndoshë organik. Sipas të dhënave të Odës Ekonomike të...

Fq.7

EDITORIAL

A JANË SHQIPTARËT VIKTIMË TË PROCESEVE?

Emin AZEMI

Qëndrimi politik i një partie, sa është i rëndësishëm për vetë atë, po aq, madje edhe më shumë, është i rëndësishëm edhe për opinionin publik . Janë të mirënjohura mënyrat e komunikimit politik dhe ato zgjidhen sipas nevojave, konteksteve e qëllimeve.

Deklarimi publik se në ndryshimet e tanishme kushtetuese nuk do të hyjnë çështjet që prekin interesat e shqiptarëve, nuk është një qëndrim që duhet mbajtur intern, qëndrim i një partie a një grupi joformal njerëzish. Se kjo është një temë mjaft e rëndësishme dhe e ndjeshme, kjo nuk kërkon ndonjë shpjegim shtesë, por ajo që ngelë e paqartë është statusi që i jepet kësaj teme, duke e ranguar atë në çështje gati interne partiake, për të cilën nuk paska nevojë të debatohet në Parlament, në media dhe në qarqet e ndryshme të shoqërisë.

Nëse një parti politike vlerëson se një temë nuk duhet hapur, se për të ekzistojnë shumë arsye që të trajtohet si e tillë, atëherë puna e parë që duhet bërë është organizimi i një brifingu me drejtuesit kryesorë të mediave në gjuhën shqipe, ku do të jepeshin hollësi dhe arsyetime të detajuara se pse akcila temë, siç janë ndryshimet kushtetuese pa problematikat shqiptare, nuk duhet të kenë vëmendjen e publikut, sepse ato si të tilla, sipas partisë, as që do të trajtohen në Parlament.

Çdo medie serioze do të ndodhet para dilemës, nëse kjo temë duhet hapur, dhe nëse jo, cilat janë arsyet?

Çdo medie serioze, e paanshme, do të duhej të ndiqte edhe rezonin e mendimit alternativ, sepse demokracia nuk është reduktuar vetëm në vendimmarrjen e partive në pushtet.

Çdo medie serioze, do të ndjehej keq para publikut, kur nuk arrin të gjejë shpjegimin e duhur se pse në ndryshimet kushtetuese, që duhet të ndodhin, nuk mund të gjejë, bie fjala, trajtim adekuat çështja e zyrtarizimit të gjuhës shqipe, por edhe shumë çështje të tjera që drejtpërdrejt prekin statusin politik, juridik, ekonomik e kulturor të shqiptarëve në Maqedoni.

Krejt kjo problmatikë nuk mund të kalojë pa një brifng me drejtuesit e mediave, ku politikanët e përfshirë në proces do të jepnin sqarime shteruese për jodomsdoshmrëinë e futjes së temave shqiptare në ndryshimet e tanishme kushtetuese dhe konform kësaj pastaj do të ridizajnoheshin edhe linjat editorile.

Kështu siç po ndodhë që redaktorët shqiptarë të njoftohen përmes debateve televizive për tema kaq sensitive, është joserioze dhe kundërproduktive për vet procesin, i cili në asnjë moment nuk është i rrezikuar nga faktori shqiptar në Maqedoni dhe më së paku nga mediat në gjuhën shqipe. Procesi si i tillë ishte i kërcënuar nga erozioni politik e moral i një pjese të popullatës maqedonase, duke filluar nga bojkotimi i referendumit e deri te abstenimi në Kuvend i debatit për ndryshimet kushtetuese.

Kultura politike e shqiptarëve edhe kësaj radhe ishte në kohezion të plotë me qëllimin politik që procesi të kursehet nga temat që mund ta s'postojnë kursin e integrimeve euroatlantike dhe këtë shqiptarët e kuptuan duke pasur mirëkuptim sidomos para referendumit.

Por, megjithatë nuk do të donim të na reprizohen situatat e viteve nëntëdhjetë kur Gligorovi i luste deputetët e PPD-së që të mos hapin tema sensitive, sepse kjo do ta irritonte VMRO-në dhe për pasojë procesi do të degradohej, duke pamundësuar përfshirjen e Maqedonisë në organizata ndërkombëtare, siç ishte atëbotë OKB dhe disa institucione të BE-së në Bruksel.

Nëse tani OKB zëvendësohet me NATO, duke dashur ta paraqesim vetën më të kujdesshëm se sa që duhet, atëherë nesër sigurisht do të duhej të jepen sqarime plotësuese nëse shqiptarët bëhen viktimë të proceseve. Madje, edhe sot kishim dashur të kërkojmë sqarime për proceset e viteve nëntëdhjetë, por ku ta gjejmë PPD-në?!

U ÇPRUSH M..., ERA DUMAN

"Kriza ekonomike në Greqi nxori në dritë për diell një pjesë të vockël të financimit të zbythjes se madhe të shqiptarëve gjithandej.
Mu si me 1913 shtetet ballkanike se bashku me Turqinë u kanë shpallur luftë shqiptarëve.
Kjo është Lufta e Tretë Ballkanike.
Degradimi ekonomik, politik, shoqëror, kulturor, gjuhësor, religjioz, moral e etik i shqiptarëve në gjithë hapësirën etnike shqiptare është si rezultat i luftës së sofistikuar e sistematike të shteteve ballkanike kundër shqiptarëve.
Greqia, Serbia e Turqia janë në garë të egër për përfitime politike, ekonomike e strategjike në trojet tona por njëkohësisht janë në koordinim të plotë për të shkatërruar gjithçka shqiptare, gjithçka që bashkon e zhvillon shqiptarët.
Në këtë luftë antishqiptare janë të përfshirë drejtpërdrejtë edhe xhuxhet Mali i Zi e Maqedonia.
Njerëz te caktuar (ekspertë, këshilltarë) e financuar nga Greqia punojnë në Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e saj gjithandej.
Njerëz te caktuar e financuar nga Serbia punojnë për Qeverinë e Shqipërisë. Turqia, Mali i Zi e Maqedonia kanë gjithashtu njerëzit e tyre që i paguajnë mirë.
Andaj sot Qeveritë shqiptare, elitat politike dhe pseudointekektuale, mjetet e informimit janë proamerikane, progjermane, proturke, proangleze, profranceze, progreke, proarabe, proeuropiane por asnjë proshqiptare.
Mu nga kjo luftë e fëlliqur antishqiptare sot shqiptarët janë në kaos, arsimi ka degraduar, shëndetësia gjithashtu, drejtësi nuk ka e zhvillimi ekonomik ka marrë teposhtezen.
Krimi, droga, padrejtësitë kanë arritur majat.
Nga kjo luftë shqiptarët për të shpëtuar kanë marrë ikën si me 1990 në Shqipëri e si gjatë viteve nëntëdhjeta në Kosovë.
Publikimi i një liste të të financuarve nga Greqia në Shqipëri është vetëm çprushje e majës së m...", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, veprimtari Murat Koci.



"GAZETAT QË REKLAMOJNË LARGIMIN!

"Gazetat sot po u bëjnë reklamë mundësive të largimit të shqiptarëve për në Gjermani, Amerikë, Zvicër... Mu kujtua koha, kur ato reklamonin çdo ditë përqindjet e fitimeve në firmat piramidale. Dje ndihmuan në zbrazjen e xhepave, sot po ndihmojnë të boshatiset Atdheu", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtari nga Tirana, Izet Duraku.

PAQARTËSITË E NJË LAJMI

"Mediet shqiptare ranë shpejtë në kurthin e një injoranti me mendje të mbrapsht, Festim Lato i cili shkrimin e Listës greke e shkrojë pa asnjë rregull drejtshkrimorë dhe e botojë në një portal që hapen për 5 minuta dhe funksionojnë vetëm 10 ditë, ditën e premte në darkë. Më tej shkrimin e botuan dy portale jo në Shqipëri, por në një shtet Ballkanik që njihet për lajme FAKE NEWS dhe përmenden për këto lloj lajme në raportet e CIA dhe të Forumit FCB. Ndërsa ditën e hënë e botuan portalet, gazetat, tv shqiptare në Tiranë e Kosovë sepse menduan se kishin zbuluar skandalin. Por e botuan pa bërë asnjë verifikim seriozë për burimin e këtij lajmi. Shqiptarët janë një popull i vrullshëm, euforik, pa rezistencë të gjatë dhe me kujtesë të shkurtër", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, Arben Llalla, historian dhe gazetar.

MEDIACitate

DIALOGU MBETET I "NGRIRË"

Bashkimi Evropian nuk e ka përcaktuar ende datën e vazhdimit të dialogut në Bruksel ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, qoftë për negociatat në nivelin politik apo bisedimet në nivelin teknik. Sipas zyrtarëve të Bashkimit Evropian, e puna rreth caktimit të takimit dhe temave të ardhshme është duke vazhduar.
"Puna është duke vazhduar në nivelin teknik, përkitazi me takimin e lartë të ardhshëm të dialogut, data e të cilit pritet të konfirmohet", tha në një përgjigje me shkrim për Radion Evropa e Lirë, Maja Kocijançiq, zëdhënëse e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian, Federica Mogherinit.
Nisur nga historia e takimeve të fundit, si në nivelin e presidentëve ashtu edhe në atë teknik, Beogradi nuk ka pranuar të ulet dhe të bisedojë me palën nga Kosova. Më 7 shtator, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq kishte refuzuar takimin me homologun e tij nga Kosova, Hashim Thaçi, pasi që autoritetet e Prishtinës, atë kohë, fillimisht nuk i kishin lejuar atij që të vizitonte liqenin e Ujmanit në veri të Kosovës.
Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës, thonë se që nga muaji mars, Serbia i ka braktisur të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e marrëveshjeve të mbetura.
Shefi i Ekipit teknik të Kosovës në dialogun me Serbinë, Avni Arifi, tha se pala e Kosovës është e gatshme për takime, por pala serbe, sipas tij, është ajo që ka refuzuar.
"Ne kemi kërkuar tri herë dhe kemi kërkuar edhe me shkrim nga BE-ja që të caktojë takimin e radhës dhe kemi kërkuar sidomos implementimin e Marrëveshjes së energjisë, por kjo është refuzuar nga pala serbe. Ne mbesim në pritje, kur ata janë të gatshme që të vazhdojnë bisedimet. Përndryshe, Kosova është e gatshme që të vazhdojë bisedimet", tha Arifi. Arifi thotë se Serbia është nuk po i zbaton shumë marrëveshje, si ajo për energjinë e shumë të tjera.
"Ka mbetur Marrëveshja për menaxhimin e integruar të kufijve dhe ndërtimin e pikave ndërkufitare, gjashtë pikave, tri nga ana e Kosovës dhe tri nga ana e Serbisë dhe është humbur donatori disa milionësh për shkak te neglizhencës së Serbisë", theksoi Arifi.

(REL, 23 tetor)

THELLOHET KRIZA NË PARTINË E MICKOVSKIT

FILLIMI I FUNDIT I VMRO-së

Nikollovski ka informuar se veç pastrimit të atyre që, siç tha ai, punuan kundër VMRO-së dhe popullit, në mbledhjen e Komitetit ekzekutiv është hapur edhe debati për secilin anëtarë që ka vepruar në të kaluarën. "Aktualisht, vendimi për shkarkim bie mbi këta persona, por gjithsesi se do ndërmerren masa për të gjitha ata që edhe në të kaluarën kanë gabuar para partisë dhe para ligjeve", ka thënë Nikollovski

Koha Evis HALILI

Shkup, 23 tetor - Thellohet kriza në VMRO-DPMNE-në e Hristijan Mickovskit. Pas ndasive në mesin e grupit parlamentar, përçarje e thellë është shënuar edhe në Komitetin Ekzekutiv të partisë. Të hënën mbrëma, Komiteti ekzekutiv i partisë është shprehur se "po përfundon me hipotekat e të kaluarës", duke aluduar kështu në largimin e disa anëtarëve të rëndësishëm nga partia.

Nënkryetari i partisë, Mitko Jançev, ish-drejtori i DSK-së, Sasho Mijallkov dhe ish-ministri Nikolla Todorov janë tre anëtarët më të lartë të partisë të cilët u shkarkuan nga të gjitha organet e VMRO-së, ndërsa u akuzuan për mbështetje të shumicës në votimin e nevojës për ndryshimin e kushtetuese të premten vonë. Veç kësaj, Komiteti ekzekutiv ka miratuar propozimin për shkarkimin edhe të deputetëve që mundësuan arritjen e shumicës, konkretisht 2/3 e votave në Parlament.

"VMRO-DPMNE ka përfunduar me hipotekat e të kaluarës. Partia më vjetër maqedonase disponon me mekanizma pastrimi dhe për këtë arsye, të mbështetur në prova të forta, ka marrë vendim për përjashtim nga partia nënkryetarin Mitko Jançev, anëtarin Sasho Mijallkov, Nikolla Todorovin dhe disa tjerë. Dua ta uroj koalicionin e ri të krimit mes Zoran Zaevit, Vice Zaevit dhe Sasho Mijallkovit. Njëherësh në Komitetin Qendror është miratuar vendimi për tetë deputetë që votua 'për' ndryshimet kushtetuese, me çka ju bëjmë thirrje ti japin dorëheqje", tha Aleksandar Nikollovski nga VMRO-DPMNE.

Nikollovski ka informuar se veç pastrimit të atyre që, siç tha ai, punuan kundër VMRO-së dhe popullit, në mbledhjen e Komitetit ekzekutiv është hapur edhe debati për secilin anëtarë që ka vepruar në të kaluarën. "Aktualisht, vendimi për shkarkim bie mbi këta persona, por gjithsesi se do ndërmerren masa për të gjitha ata që edhe në të kaluarën kanë gabuar para partisë dhe para ligjeve", ka thënë Nikollovski. I pyetur nëse do të shkarkohet edhe ish-kryeministri Nikolla Gruevski, Nikollovski tha se

ALEKSANDAR NIKOLLOVSKI

VMRO-DPMNE ka përfunduar me hipotekat e të kaluarës. Partia më vjetër maqedonase disponon me mekanizma pastrimi dhe për këtë arsye, të mbështetur në prova të forta, ka marrë vendim për përjashtim nga partia nënkryetarin Mitko Jançev, anëtarin Sasho Mijallkov, Nikolla Todorovin dhe disa tjerë. Dua ta uroj koalicionin e ri të krimit mes Zoran Zaevit, Vice Zaevit dhe Sasho Mijallkovit

për kryetarin e Nderit të partisë, Gruevskin, nuk ka asnjë informacion se ka punuar në sigurimin e 80 votave për nevojën e ndryshimeve kushtetuese.

"Në iniciativë të Hristijan Mickosit ishte shqyrtuar propozimi, të cilin ai e dha për mbajtje të Kongresit të jashtëzakonshëm për votim të besimit për kryetarin e partisë. Kryetari i partisë nuk ka marrë pjesë në seancë dhe Komiteti njëzëshëm vendosi ta refuzojë këtë propozim dhe konsideron se partia nuk ka nevojë të mbajë Kongres të jashtëzakonshëm", potencoi Nikollovski.

Nënkryetari Mitko Jançev, i shkarkuar tashmë, ishte një nga të parët që nuk pajtohej plotësisht me qëndrimin e partisë për të mos thirrur për votim në referendum, ndërsa më 30 shtator, doli dhe votoi "kundër". Mospajtime, siç merret vesh, kishte pasur rreth propozimit për shkarkimin edhe të Sasho Mijallkovit. Një pjesa e anëtarëve të Komitetit ekzekutiv kishin kundërshtuar, ndërsa Mickovski ishte detyruar ta mbështet shumicën dhe me këtë, ta largojë nga partia Mijallkovin. Njëjtë ishte situata edhe më shkarkimin e ish-ministrit të Shëndetësisë, Nikolla Todorov, i akuzuar nga partia se ka punuar që referendumi të mos dështojë.

VMRO ka vendosur gjithashtu të ndërpret bashkëpunimin me deputetin e partisë GROM, Pançe Minov, ndërsa i njëjti nuk do të ketë vend në grupin parlamentar të VMRO-së. Minov ishte njëri nga tetë deputetët që votoi për nevojën e ndryshimeve kushtetuese në Parlament, ndërsa akuzoi Mickovskin për qasje jo demokratike pas shkarkimit të nënkryetarit Mitko Jançev nga partia.

Mbështetje e fuqishme amerikane për Marrëveshjen e Prespës

Shkup 23 tetor - SHBA fuqishëm e mbështet Marrëveshjen e Prespës dhe kjo është me rëndësi thelbësore për të ardhmen euroatlantike të Maqedonisë. Zëvendësndihmës sekretari për çështje evropiane i SHBA-së, Methju Palmer, gjatë vizitës në Maqedoni dje, shprehu mbështetje të fuqishme amerikane për Marrëveshjen nga Prespa. Palmer tha se tetëdhjetë votat për mbështetje të Marrëveshjes së Prespës në Kuvend paraqesin kthesë historike për të ardhmen evropiane të Maqedonisë dhe popullit të Maqedonisë, ka deklaruar sot zëvendësndihmës sekretari shtetëror për çështje evropiane të SHBA-së. "Si

që lëvizni në rrugën drejt integrimeve evropiane dhe euroatlantike, anëtarësimit në NATO dhe hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, Maqedonia, liderët e Maqedonisë, populli i Maqedonisë mund të konsiderojë në përkrahjen e SHBA-së. Në takimin me Zaevin kemi biseduar për Marrëveshjen e Prespës, implementimin e saj, procesin e integrimit të vendit në NATO dhe BE, si dhe mundësitë për bashkëpunim të mëtejmë mes Maqedonisë dhe SHBA-së", ka thënë Palmer. Zaev ka theksuar se takimi me Palmerin vjen në një moment të rëndësishëm dhe vetëm disa ditë nga hapi i madh drejt të ardhmes së bërë në Kuvend. "U pajtuam se vendimi i deputetëve ka peshë historike. Ai vendim i deputetëve edhe nga pushteti dhe opozita edhe një herë konfirmuan përcaktimin euroatlantik për të ardhmen e vendit. Deputetët dhe forcat demokratike në vend, guximshëm morën përgjegjësinë dhe shkruan historinë", ka thënë Zaev.

Edhe Makroni përshëndet votimin në Parlament

Shkup, 23 tetor - Mbështetje për Marrëveshjen e Prespës dhe votimin e fillimit të ndryshimeve kushtetuese në Parlament shprehu edhe Franca. "Franca me kënaqësi ka konstatuar se votimi më 19 tetor në Kuvendin e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë e kishte shumicën e nevojshme prej dy të tretave, për fillimin e pjesës për shqyrtimin e amendamenteve kushtetuese, me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes së Prespës, të firmosur më 17 qershor midis Athinës dhe Shkupit. Franca shpreson se debatet në Kuvend do të çojnë drejt rishikimit të Kushtetutës. Siç kujton presidenti Makron, Marrëveshja e Prespës është e mirë për vendin, për rajonin dhe për Evropën", thuhet në deklaratën e zëdhënësit të Ministrisë për Evropë dhe Punë të Jashtme të Francës, Zonja Anjes fon der Mil", transmeton Ambasada e Francës.

Koxias: Në interesin tonë është që IRJM të stabilizohet

Athinë, 23 tetor - Çfarë fqinji duam, nën ndikim të Turqisë? Të ndarë mes Shqipërisë dhe Bullgarisë?, pyeti ish-ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Koxias gjatë fjalimit të tij nga qyteti Iraklio në ishullin grek Kretë, duke u përqendruar në çështjen e emrit, bisedimeve dhe zgjidhjes mes dy vendeve. Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, Koxias foli në ngjarjen e organizuar nga Lëvizja e ideve dhe aktiviteteve Prato dhe i ka përfshirë të gjitha aspektet në politikën e jashtme greke. "Duam që fqinji ynë më i afërt të jetë nën ndikim, nën kontroll të fuqive të treta, siç është Turqia? Duam, siç duan disa, dështim të një shteti në Ballkan, që ta destabilizojë dhe të ndahet ky vend mes Bullgarisë dhe Shqipërisë? Ose duam të kemi stabilitet në Ballkan, stabilitet të kufirit, zhvillim të ndikimit të vendit tonë në rajon dhe të mundemi të bëjmë aleanca?, pyeti Koxias. Duke folur për marrëdhëniet e Rusisë, ish-shefi i diplomacisë greke tha se zgjidhja e problemit mes Maqedonisë dhe Greqisë dhe ndryshimi i emrit nuk është që "Maqedonia Veriore të hyjë në NATO", por për shkak se kjo është zgjidhje e një problemi edhe për Greqinë edhe nga interesi nacional. Në këtë kontest, ish-ministri i jashtëm i Greqisë, theksoi se në negociatat nuk duhet të lejojë përzierje të shumë palëve, sepse nuk do të gjendet zgjidhje.

NDRYSHIMET KUSHTETUESE VETËM PËR MARRËVESHJEN E PRESPËS

S'KA VEND PËR KËRKESA ETNIKE!

Ndryshimet kushtetuese të iniciuara nga Qeveria e Maqedonisë, sipas ekspertëve juridik, për fat të keq nuk kane të bëjnë me të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe, por vetëm me ato burojnë nga Marrëveshja e Prespës si çështje e kontestit ndërshtetëror midis Maqedonisë dhe Greqisë. Madje, Denko Maleski thotë se nuk është ide e mençur që shqiptarët, në këtë kohë stresi për maqedonasit, të dorëzojnë edhe amendamente etnike



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 23 tetor - Pas plot 17 vitesh kur Kushtetuta e Maqedonisë pësoi ndryshimet e para pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, tani sërish pas nënshkrimit të Marrëveshjes se Prespës, e njëjta do të ndryshojë duke futur kështu amendamentet që kanë të bëjnë me ndërrimin e emrit të shtetit. Debati, i cili po zhvillohet menjëherë pas 80 votave të deputetëve "për" në Parlament, është pikërisht ajo nëse do të dorëzohen amendamente edhe për të drejtat e shqiptarëve. Si çështje e rëndësishme do të jetë ndryshimi i preambulës dhe emrit të shtetit si shtet i qytetarëve të Maqedonisë pa favorizuar asnjë etni tjetër dhe gjuha shqipe si gjuhë zyrtare, pa 25 përqindëshin e përmendur taksativisht. Denko Maleski, njohës i mirë i çështjeve juridike dhe politike, është i mendimit se e gjithë procedura për hapjen e Kushtetutës nuk duhet të ngarkohet me amendamente tjera përveç atyre që kanë të bëjë Marrëveshjen e Prespës.

"Një kohë të gjatë kishim prezent një moment krize për gjithë shtetin dhe tani kur e tejkaluam këtë krizë, gjegjësisht fazën e parë për hapjen e Kushtetutës, Parlamentin e pret punë edhe më e rendë për finalizimin e ndryshimeve kushtetuese. Mendoj se për etnitetin maqedonas, ndryshimi i emrit paraqet stres, prandaj më së paku është e nevojshme të ngarkohet edhe me amendamente të reja, sidomos kur bëhet fjalë për marrëdhëniet ndëretnike midis maqedonasve dhe shqiptarëve", thotë Malevski. Kam mirëkuptim, thotë ai, për të gjithë liderët e partive shqiptare, sidomos për popullin shqiptarë në Maqedoni se duan të dorëzojnë amendamente për njohjen e gjuhës shqipe edhe në Kushtetutë, sepse me sa mbaj mend unë, e gjithë proceduara e miratimin të Ligjit për gjuhën shqipe ka përfunduar.

"Pengesë e vetme e di se është firmosja e Ligjit nga presidenti. Dhe, nuk mendoj se është mençuri që serish të kthehet në debat kjo çështje kur maqedonasit dy muajt e fundit kanë qenë nën trysninë e liderëve të shteteve më të fuqishme botërore dhe nga shteti fqinj Greqia për ndryshimin e emrit. Mendoj se nuk është mirë që tani të jenë në trysni edhe nga partitë shqiptare. Frikësohem shumë se pikërisht tani është momenti për finalizimin e Ligjit për gjuhën shqipe, kur kemi sigurimin e shumicës parlamentare, gjegjësisht 2/3 që në të ardhmen mund të çojë vendin përpara në procese që do të luanin rol të rëndësishëm në pajtimin midis etniteteve më të mëdha në Maqedoni, maqedonasve dhe shqiptarëve", thotë Maleski, duke mos lenë anash dhe mundësinë që edhe sikur të kalojnë në Parlament të gjitha amendamentet për ndryshimin e Kushtetutës, sërish fjalën e fundit ta ketë presidenti i shtetit dhe të mos vendos firmën e tij për ndryshimet kushtetuese. Mersin Maksuti, ekspert i çështjeve juridike, thotë se të drejtë të propozimit të amendamenteve tjera përveç Qeverise kanë dhe deputetët tjerë, por se propozimet e reja duhet fillimisht të pranohen nga vetë Qeveria si propozues i këtyre ndryshimeve kushtetuese, në rastin konkret të hyjnë në tekstin e propozim-amendamenteve dhe të procedohen më tej.

"Kjo është çështje e diskutimit politik me Qeverinë, por logjika e interpretimit juridik thotë që të gjitha propozimet tjera të mundshme duhet të jenë sipas përmbajtjes dhe frymës së Marrëveshjes së Prespës, pasi për këtë çështje u iniciua ndryshimi i Kushtetutës dhe u arrit konsensusi i 2/3 të deputetëve", thotë Maksuti. Ndryshimet kushtetuese të iniciuara, sipas Maksutit, për fat të keq nuk kane të bëjnë me të drejtën e përdorimit të gjuhës shqipe, por burojnë nga Marrëveshja e Prespës si çështje e kontestit ndërshtetëror midis Maqedonisë dhe Greqisë. "Për sa i përket të drejtës së përdorimit të gjuhës shqipe, do të dëshiroja që forcat politike aktuale maqedonase dhe shqiptare të gjejnë forcën dhe në një moment të ri politik, ta fusin gjuhën shqipe në Kushtetutë si kategori e garantuar juridike e që do të thotë që të gjitha propozimet tjera të deputetëve, duhet të jenë sipas përmbajtjes dhe frymës së Marrëveshjes së Prespës pasi për këtë çështje u inicua ndryshimi i Kushtetutës dhe u arrit konsensusi i 2/3 të deputeteve", thotë Makuti. Maksuti madje thotë se Kushtetuta e Maqedonisë nuk parasheh që presidenti t'i nënshkruaj amendamentet kushtetuese me qëllim të hyrjes në fuqi të tyre, sepse shpallja në fuqi e amendamenteve bëhet vetëm me votimin e 2/3 të numrit të përgjithshëm të deputetëve të Parlamentit.

Ndryshe, kundër hapjes së kërkesave shqiptare në ndryshimet që priten të bëhen në Kushtetutë është shprehur edhe Bashkimi Demokratik për Integrim, zyrtarë të së cilës në disa raste janë shprehur se momentalisht, me rëndësi të veçantë është integrimi në NATO.

DENKO MALESKI

Tani kur e tejkaluam këtë krizë, gjegjësisht fazën e parë për hapjen e Kushtetutës, Parlamentin e pret punë edhe më e rendë për finalizimin e ndryshimeve kushtetuese. Mendoj se për etnitetin maqedonas, ndryshimi i emrit paraqet stres, prandaj më së paku është e nevojshme të ngarkohet edhe me amendamente të reja, sidomos kur bëhet fjalë për marrëdhëniet ndëretnike midis maqedonasve dhe shqiptarëve

MERSIM MAKSUTI

Kjo është çështje e diskutimit politik me Qeverinë, por logjika e interpretimit juridik thotë që të gjitha propozimet tjera të mundshme duhet të jenë sipas përmbajtjes dhe frymës së Marrëveshjes së Prespës, pasi për këtë çështje u iniciua ndryshimi i Kushtetutës dhe u arrit konsensusi i 2/3 të deputetëve

EDHE REMENSKA KËRKON PAJTIM PËR INTERESA KOMBËTARE

Patriotizmi në shekullin 21 është përkushtim i sigurimit të së ardhmes të sigurt për Republikën e Maqedonisë dhe për rrugën e saj në integrimet euroatlantike, të bëhet anëtarja e 30-të e NATO-s dhe t'i fillojë negociatat me BE-në. Porosinë e tillë e dërgoi nënkryetarja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Frosina Tashevska-Remenski dje kur dorëzoi kurorë me lule në përmendoren e Goce Dellçevit me rastin e shënimit të 23 Tetorit - Ditës së luftës revolucionare të Maqedonisë. Ajo potencoi se rruga drejt BE-së dhe NATO-s është e shtruar me vendime të cilat duhet të sillen me konsensus në interes të interesave kombëtare të RM-së, dhe për atë pajtimi duhet të na bashkojë të gjithëve rreth interesave të RM-së, ndërsa jo rreth interesave të partive politike. Ajo shtoi se personalisht nuk ka me kë të pajtohet sepse nuk është në marrëdhënie të këqija me askënd, por potencoi se politikisht ajo që e reflekton Kuvendit si ambient dhe si atmosferë për punë duhet të sigurojë rehati mes qytetarëve. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve në lidhje me mandatin e deputetëve të Nikolla Gruevskit pas gjykimit për rastin "Tank" , ajo tha se një është çështja për marrjen e imunitetit, ndërsa tjetër është çështja për ndërprerje të mandatit i cili është konfirmuar me ligj.

POLITIKAT PUBLIKE TË GJYQËSORIT

EKZISTOJNË PENGESA LIGJORE PËR PUNË TRANSPARENTE

Të dhënat e siguruara nga Instituti për të Drejtat e Njeriut, thonë se Këshilli Gjyqësor nuk disponon me plan për komunikimi me opinionin. Siç thuhet në Publikimin fundit të IDNJ-së, në vitin 2016, Këshilli ka miratuar një Doracak për komunikim me gjykatat, ku përshkruhen mënyrat dhe llojet e komunikimit të gjykatave me publikut. Megjithatë, në këtë Doracak nuk theksohet mënyrë e komunikimit që Këshilli Gjyqësor duhet ta ketë me opinionin

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 23 tetor - Ndryshimi i kornizës ligjore të Ligjit për Këshillin Gjyqësor që u bë gjatë periudhës së fundit, e ka përmirësuar transparencën e këtij institucioni të rëndësishëm gjyqësor, posaçërisht në pjesën zgjedhjes së gjykatësve, publikimit të procesverbaleve në faqen zyrtare e kështu me radhë. Instituti për të Drejtat e Njeriut në publikimin e fundit për transparencën Këshillit Gjyqësor, thotë, se përkundër përparimit që është bërë edhe më tej ekzistojnë pengesa ligjore për punë transparente të Këshillit në fjalë.

"Gjatë kohës kur diskutohet për përgjegjësinë e gjykatësit apo kryetari të gjykatës, sipas normave ligjore këto seanca janë të mbyllura për opinioni. Por, kjo praktikë vazhdon të zbatohet edhe atëherë kur gjykatësi apo kryetari i gjykatës kërkojnë prezencën e publikut. Pra, në këto rrethana Këshilli Gjyqësor vendos se a do të lejoj apo jo opinionin të merë pjesë në këtë seancë. Gjithashtu kontradikta e radhës lidhet me dispozitën e nenin 32, paragrafi 2, me çka parashihet që Këshilli gjyqësor mund ta përjashtoi opinionin, me qëllim ruajtjen e reputacionit dhe dinjiteti të gjykatësit, mes tjerash edhe për gjykatësit kandidat. Ndërkohë, gjykatësi kandidat para Këshilli mund të paraqitet vetëm në procedurë për zgjedhje të gjykatësit, për të cilën raste në paragrafin 4 është paraparë prezenca e obliguar e opinionit", thonë nga Instituti për të Drejtat e Njeriut. Të dhënat e siguruara nga Instituti për të Drejtat e Njeriut, thonë se Këshilli Gjyqësor nuk disponon me plan për komunikimi me opinionin. Siç thuhet në Publikimin fundit të IDNJ-së, në vitin 2016, Këshilli ka miratuar një Doracak për komunikim me gjykatat, ku përshkruhen mënyrat dhe llojet e komunikimit të gjykatave me publikut. Megjithatë, në këtë Doracak nuk theksohet mënyrë e komunikimit që Këshilli Gjyqësor duhet ta ketë me opinionin. Monitorimi i vazhdueshëm i punës së Këshillit Gjyqësor, nga IDNJ ka ndikuar që kjo e fundit të konstaton se Këshilli në fjalë si një ndër institucion më të rëndësishme gjyqësor në vend ka nevojë për përmirësim të strategjisë për komunikim.

"Përveç vendosjes procedurave formale (kryetar – zëvendës), përfshi edhe PR shërbimin e Këshillit Gjyqësor, vlerësojmë se ky institucion duhet të prezantohet në opinioni përmes formave të ndryshme siç janë deklaratat publike, intervistat, TV debatet, debatet profesionale, brifingjet me gazetar e kështu me radhë", thonë nga IDNJ-ja.

Ndryshe nga përcjellja e punës së Këshillit Gjyqësor dhe aktivitete që ato i realizohet, IDNJ ka konstatuar se faqja zyrtare e këtij institucioni përmban të dhënat bazë për punën e tyre, megjithatë për shkak të ngjashmërisë së kumtesave shumë lehtë mund të vije deri te keqkuptimi i përmbajtjes së njoftimeve të tyre. Po ashtu, nga IDNJ thonë se gjatë kërkimit të ndonjë informacioni në ueb faqen e Këshillit, shumë lehtë mund të vërehen mungesat kronologjike të shkresave. Për mënjanimin e këtyre mungesave nga atje theksojnë se Këshilli Gjyqësor duhet të furnizohet me pajisje dhe kuadro të përshtatshme.

MIJALLKOVIT NUK I ËSHTË KTHYER PASAPORTA

Gjykata Penale pranë Gjykatës Themelore Shkupi 1 nuk ka vepruar sipas kërkesës për heqje të masës për kujdes të Sasho Mijalkov. "Në lidhje me informacionet e lidhura me personin S.M. të akuzuar në shumë lëndë të PSP-së nga Gjykata Themelore Shkupi 1, informojmë se Këshilli Gjyqësor pranë kësaj gjykate aspak nuk ka vepruar sipas kërkesave për heqje të masës së kujdesit për personin e potencuar dhe se informacionet e lëshuara në opinion janë absolutisht të pasakta", sqarojnë për MIA-n nga Gjykata Themelore Shkupi 1. Ndryshe, disa nga mediat publikuan se ish drejtorit për kundërzbulim Mijallkov i është kthyer pasaporta.

QYTETARËT PËRFITOJNË PAK NGA KAMATAT E DEPOZITAVE

KAMATAT ULEN, RRITEN KURSIMET

Kursimtarët preferojnë t'i ruajnë paratë e tyre me një siguri më të madhe në banka dhe të përfitojnë sado pak nga këto mjete, në vend se të investojnë në biznese apo mjete të tjera të investimit

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 23 tetor - Ulja e madhe e fitimit nga kamatat nuk ka zvogëluar edhe kursimet në bankat vendore. Përkundrazi, të dhënat e Bankës Popullore tregojnë se në dhjetë vitet e kaluara janë ulur për më shumë se trefish shkallët e normave të interesit, ndërsa nga ana tjetër - në vazhdimësi shënohet rritje e kursimeve të qytetarëve. Sipas të dhënave të Bankës Popullore të Maqedonisë, depozitat e amvisërive në Maqedoni janë rritur prej 2 miliardë e 460 milionë euro në vitin 2010 në 3 miliardë e 888 milionë euro në fund të muajit gusht të këtij viti.

Nga ana tjetër, kamatat e kursimeve janë zvogëluar nga 7 për qind në vitin 2010 në 1.4 për qind në gusht të këtij viti. Ekspertët e financave thonë se pavarësisht normave të ulëta të interesit, qytetarët nuk kanë ndonjë alternativë më të sigurt për kursimet e tyre. Sipas tyre, kursimtarët preferojnë t'i vendosin paratë e tyre me një siguri më të madhe në banka dhe të përfitojnë sado pak nga këto mjete, në vend se të investojnë në biznese apo mjete të tjera të investimit.

"Qytetarët preferojnë të ruajnë të hollat e tyre nëpër banka edhe pse nuk kanë ndonjë fitim të caktuar për shkak se kursimi në banka akoma paraqet mënyrën, të cilës ata i besojnë në vend të investimit në ndonjë biznes. Me fjalë të tjera, amvisëritë tek ne i deponojnë të hollat në librezat e kursimit si mënyrë më e sigurt për të ruajtur të hollat edhe nga pasojat e padëshiruara siç janë vjedhjet eventuale, apo humbjet nga dështimi i investimit e kështu me radhë", thonë ekonomistët.

Vlerësohet se depozitat apo kursimet, mbeten mënyra kryesore e investimit të hollave në mungesë të zhvillimit të formave të tjera të investimeve, por edhe besimit të mjaftueshëm që të investohet për shembull në sipërmarrje, në sigurimin jetësor, në letrat me vlerë në bursë e kështu me radhë. Në parim, niveli i kursimeve në një ekonomi varet edhe nga niveli i të ardhurave, numri i madh i mërgimtarëve në shtetet e huaja, sistemi tatimor, ekonomia informale apo puna në të zezë, vendosja e llogarive transaksionale, rritja e pagesave pa para të gatshme në dorë, por edhe besimit në valutën vendore të denarit. Mbajtja e kursimeve në institucionet financiare në Maqedoni nga ekonomitë familjare, sipas ekspertëve të çështjeve ekonomike, tregon për besueshmërinë dhe stabilitetin e bankave komerciale që veprojnë në vend.

Sociologët thonë se edhe nxjerrja e parave nga jastëku dhe transferi i tyre në banka, si dhe krizat e vazhdueshme politike, jo vetëm në Maqedoni, por edhe në rajon, kushtëzojnë që qytetarët që kanë mundësi të kursejnë thjeshtë për ditë të zeza.

"Dëgjojmë shpesh për grabitje të ndryshme në tërë vendin, andaj nga frika të mos i humb ato pak para që i kam për nevoja urgjente, vendosa ti depozitojë në bankë. Përveç në punë shteti, merrem edhe me bujqësi që tu bëj ballë harxhimeve të larta të jetesës. Nuk e kam ndërmend të fitoj diçka nga kamatat, por kryesorja të hollat të mos jenë në shtëpi, por në llogari bankare", thotë Mislimi, një banor i Shkupit.

Gjithashtu, në favor të rritjes së kursimeve është edhe masa qeveritare që qytetarët e Maqedonisë të mos paguajnë tatim në kamatat e depozitave deri në anëtarësimin e vendit në BE.

Ndryshe, Shqipëria renditet e para në rajon lidhur me kursimet dhe nivelin e lartë të depozitave që i ruajnë në banka. Sipas të dhënave krahasuese të publikuara nga Banka Botërore, Shqipëria ka nivelin më të lartë të depozitave në banka prej bile 70 për qind, në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto në rajon.

Pas Shqipërisë, renditet Bullgaria, me depozita sa 68 për qind e PBB-së, Kroacia me 64 për qind dhe Mali i Zi me 60 për qind. Nga shtetet e tjera, kursimet e popullsisë në banka në Maqedoni janë sa 52 për qind PBB-së apo afër 4 miliardë euro, që është e përafërt me nivelin e kursimeve të Sllovenisë, me 53 për qind të PBB-së.

NË KËRKIM TË ZGJIDHJES LIGJORE

USHQIMI I TEPËRT, JO TË HIDHET POR TË DONOHET

Në Maqedoni gjatë vitit hidhen 5000 ton ushqim i sigurt, me të cilin mund të ushqehen 13 mijë njerëz me nga tre vakte në ditë. Drejtori i NP "Higjiena Komunale Shkup" theksoi se ushqimi i tepërt nuk duhet të hidhet në deponi, por duhet të donohet

Koha — Remzije BILALLI

Shkup, 23 tetor - Organizatat e ndryshme jo qeveritare në bashkëpunime me përfaqësues të institucioneve përkatëse si dhe Banka për ushqim në Maqedoni, kanë ardhur në përfundim se është e nevojshme të ndryshohet dhe plotësohet një pjesë e caktuar e Ligjit për siguri të ushqimit dhe posaçërisht të rregullohet mënyra e deponimit dhe transportimit.

Problematikat e ushqimit do të duhet të përfshihen edhe në dy akte të reja nënligjore, kurse këtu hyjnë edhe ndryshimet të ligjeve për donacion dhe atyre ligjeve të cilat kanë të bëjnë me politikat tatimore. Kjo për shkak të lirimit dhe stimulimit të bizneseve dhe operatorëve me ushqim, të cilët do të donin të dhuronin ushqimin.

Në Maqedoni gjatë vitit hidhen 5000 ton ushqim i sigurt, me të cilin mund të ushqehen 13 mijë njerëz me nga tre vakte në ditë. Në kuadër të këtyre të dhënave shqetësuese dhe rritjes së numrit të personave që kërkojnë ushqim, ditë më parë në Qendrën Informative të Bashkimit Evropian u mbajt tryezë e rrumbullakët me temën "Politikat nacionale dhe evropiane me pasojat nga hedhja e ushqimit: A na nevojitet Ligj i ri për moshedhje të ushqimit apo ndryshim dhe avancim i një pjese të ligjeve tashmë ekzistuese tek ne?" Drejtori i NP "Higjiena Komunale Shkup" theksoi se ushqimi i tepërt nuk duhet të hidhet në deponi por duhet të donohet tek organizatat e ndryshme që të mund të shpërndahet tek njerëzit që kane nevojë. Ai me tej shtoi se në qoftë se ky ushqim nuk mund të përdoret nga njerëzit mund t'i shërbehet kafshëve.

Kryetar i Bankës për ushqim – Maqedoni, Dushko Hristov, është shprehur se amvisëritë janë hedhësit më të mëdhenj të ushqimit në Maqedoni, ndërkaq më së shumti hidhet buka si prodhim.

"Në Maqedoni, sipas hulumtimeve tona, theksoi Hristov, 70 deri 80 mijë njerëz kanë dy deri tre shujta në javë. Këto të dhëna janë marrë në bazë të hulumtimeve kryqëzuese në tre-katër vitet e fundit nga ana e 13 organizatave të cilat punojnë në 11 qytete në vend. Në Shkup, në baza ditore ka nevojë për. minimum 13 mijë e më shumë shujta. Sipas Hristov, jo vetëm rastet sociale kanë nevojë për ushqim, kanë nevojë edhe ata me të ardhura të ulëta, ndërkaq ata në Maqedoni, janë në numër më të madh", tha Hristov.

Sekretarja e përgjithshme e Federatës evropiane të Bankave për ushqim – FEBA, Angela Frigo ka thënë se në Maqedoni ka potencial të madh posaçërisht kur bëhet fjalë për zhvillim të disa aktiviteteve në vijim, ndërkaq thelbi është të mbështeten njerëzit të cilët kanë nevojë dhe të evitohet hedhja e tepricës së ushqimit. Më tej ajo potencoi se në BE punohet shumë në këtë çështje, përkatësisht në humbjen e ushqimit dhe informoi se ka filluar platforma nga ana e KE-së për analiza dhe gjetje të zgjidhjeve.

Në nivel evropian, brenda vitit hidhen 88 mijë tonë ushqim dhe atë nga vetë prodhimi deri te shfrytëzuesi i fundit. Gjysma nga kjo shumë hidhet nga vetë amvisëritë.

Reshje të shiut, erë veriore dhe temperatura më të ulëta

Shkup, 23 tetor - Valë e ftohtë e shoqëruar me reshje të kohëpaskohshme të shiut dhe me erë të përforcuar veriore me temperatura të ulëta pritet në vend të mërkurën dhe të enjten. Të mërkurën paradite moti do të jetë me vranësira të ndryshueshme me reshje të kohëpaskohshme lokale të shiut, ndërsa në orët e pasdites vranësirat do të ulen në mbarë vendin.

Temperatura do të lëviz prej katër deri 21 gradë Celsius. Të mërkurën nga fundi i ditës dhe gjatë natës përmes Maqedonisë do të kalojë një valë e ftohtë e shoqëruar me reshje të kohëpaskohshme të shiut dhe erë të përforcuar veriore, temperatura minimale do të lëviz prej minus një deri në tetë, ndërsa ajo e ditës prej 15 deri 22 gradë. Të enjten ende do të fryjë erë e përforcuar veriore, ndërsa temperatura e ditës do të ulet dukshëm dhe do të lëviz prej 10 deri 18 gradë.

Temperatura e mëngjesit sipas paralajmërimeve do të jetë prej minus dy deri shtatë gradë.

Nga e premtja temperaturat ditore do të jenë në rritje graduale, por ato të mëngjesit në disa vende do të jetë nën zeron dhe do të lëvizin prej minus tre deri gjashtë gradë.

Temperatura e ditës të premten do të arrij deri 21 gradë, ndërsa gjatë fundjavës deri 24 gradë Celsius.

188 shtetase të huaja u arrestuan në lokalet e Pollogut

Tetovë, 23 tetor - Brenda nëntë muajve të kaluar, në rajonin e Pollogut, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë ka realizuar 50 aksione kontrolluese në lokale të natës. Sipas të dhënave të Policisë, prej tyre 33 aksione janë realizuar në Tetovë dhe 17 në Gostivar. Këto aksione janë ndërmarrë në kuadër të aktiviteteve për zbulimin dhe sanksionimin e shtetaseve të huaja të cilët eventualisht kanë mundur të jenë të përfshira në vepra të ndryshme penale. "Në këto kontrolle, kryesisht të kryera në muajt e verës (korrik, gusht dhe shtator), gjithsej janë zbuluar 188 shtetase të huaja. Prej tyre, 154 shtetase të huaja janë ndaluar në Tetovës dhe 34 në Gostivar. Shumica prej tyre janë nga Shqipëria, saktësisht 122, Nga Serbia 38, Nga Kosova 17, nga Bullgaria 5, dy nga Mali i Zi dhe poashtu dy nga Sllovenia. Gjatë aksioneve janë ndaluar 201 shtetase nga Maqedonia, ndërsa shtetaset e huaja kanë qenë të moshës prej 18 deri në 45 vjeçar", thuhet në raportin e Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë. Shumica e shtetaseve të huaja, pas arrestimit, janë dërguar në Njësinë për Kriminalitet Ndërkufitar, Migracion, të huaj dhe riatdhesim. *(U.H)*

Rreth 50 milionë euro për borxhet e komunave

Shkup, 23 tetor - Me rebalancin e buxhetit, Qeveria synon shlyerjen e 51 për qind të borxheve të cilat i kanë njësitë e bashkëqeverisjes lokale. Në seancën e fundit të Qeverisë u miratua vendimi me çka përmes Ministrisë së Financave janë siguruar 3.2 miliard denarë (48 milionë euro) mjete këto që do t'ju shpërndahen 81 komunave në Maqedoni për larjen e borxheve. Kujdestari i arkës shtetërore, Ministri i Financave, Dragan Devdovski, ka theksuar se borxhi i plotë i komunave arrin deri ne 6 miliardë denarë, (98 milion euro). "Qeveria në seancën e sotshme miratoi vendim të ri ligjore, me të cilën rregullohet mbështetja financiare atyre komunave që janë paraqitur se kanë borxhe. Me rebalancin e janë siguruar mjete për shlyerjen e këtyre borxheve. Qëllimi i këtij hapi është përforcimi i kapacitetit fiskal të komunave dhe larja e borxheve ndaj bizneseve", tha Tevdovski.

Në internet më së shumti përmes telefonit

Shkup, 23 tetor - Në Maqedoni 79.3 për qind nga amvisëritë në tremujorin e parë të vitit kanë qasje në internet në shtëpi. Të dhënat e Entit shtetëror për statistikë tregojnë se pjesëmarrja e amvisërive sipas tipit të vendbanimit me internet me shtrirje të gjerë fikse në numrin e përgjithshëm të amvisërive është 70.4 për qind në vitin 2018.

Në tremujorin e parë të vitit 2018, prej popullatës së përgjithshme të moshës prej 15 deri 74 vjeç, internet kanë shfrytëzuar 79.2 për qind, ndërsa 68.7 për qind e kanë përdorur çdo ditë ose pothuaj çdo ditë. Telefoni mobil ose telefoni i mençur kanë qenë mjeti më i përdorur për qasje në internet te shfrytëzuesit e internetit në këtë periudhë, ndërsa më së shumti 91.8 për qind te personat e moshës prej 15 deri 24 vjeç.Të dhënat statistikore tregojnë se 74.9 për qind nga personat kanë shfrytëzuar kompjuterë, laptopë, telefona të mençur, tableta ose aparate tjera transmetuese në punë, 31.6 të personave në çdo kohë kanë përdorur internet, kanë porositur, blerë mallra ose shërbime përmes internetit në 12 muajt e fundit, ndërsa shumica 54.9 për qind prej tyre kanë blerë veshmbathje ose pajisje sportive.

PRODHIMTARIA ORGANIKE E USHQIMIT

NEVOJITET RIADAPTIMI I TOKAVE BUJQËSORE

Për herë të parë shpallet edhe thirrje publike për ndarjen e tokës shtetërore të dedikuar vetëm për prodhimtarinë organike, kurse Ministrisë e Bujqësisë promovoi edhe Regjistrin e ri të operatorëve organik. Masat që favorizojnë këtë lloj prodhimtarie përfshijnë edhe subvencionet deri me 100 për qind më të larta në raport me prodhimtarinë konvencionale. Sipas Ligjit për prodhimtari organike, në Republikën e Maqedonisë për një hapësirë konvencionale që të bëhet organike nevojiten 2-3 vite

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 23 tetor - Prodhimtaria organike e ushqimit paraqet potencial të madh për zhvillimin e ekonomisë rurale në Maqedoni si dhe punësimin e fermerëve të rinj. Gjithashtu për dallim prej prodhimtarisë konvencionale si bujqësore ashtu edhe blegtorale, ajo nuk ka problem me shitjen dhe plasmanin e sigurt. Mirëpo, përkundër rritjes së interesimit për ushqimin organik nga Maqedonia në tregjet evropiane, që e dëshmojnë edhe shembuj të suksesshëm si grosha dhe kërpudhat organike që shiten në Zvicër prej vitit 2016, megjithatë vetëm 0.5 për qind e tokave bujqësore në Maqedoni janë të mbjella me prodhimtari organike. Kjo paraqet një sasi shumë të vogël në raport me mundësitë dhe kërkesat e tregut sidomos atij të huaj për një ushqim të shëndoshë organik.

Sipas të dhënave të Odës Ekonomike të Maqedonisë, në shtet janë të regjistruar vetëm 533 fermerë të prodhimtarisë organike që më së shumti kultivojnë kultura të perimeve dhe të drithërave në një tokë prej afër 3200 hektarë.

ADAPTIMI I PRODHIMTARISË BUJQËSORE NË ATË ORGANIKE

Sipas ekspertes Valentina Kolar, ekziston kërkesë për ushqim organik në tregun vendor dhe sidomos në tregjet e huaja, ku konsumatorët se vjen e më shumë kërkojnë prodhime që do të mbrojnë dhe përmirësojnë shëndetin e tyre. Bile konsumatorët evropian kanë humbur besimin ndaj furnizuesve nga Kina dhe India dhe gjithnjë e më tepër po kthehen kah prodhimet vendore. Në këtë drejtim, edhe prodhuesit vendor duhet të kërkojnë shansin e tyre, duke adaptuar prodhimtarinë e tyre bujqësore ndaj kërkesave të tregut dhe duke shfrytëzuar potencialin e madh që kemi si shtet lidhur me prodhimtarinë organike shton më tej ajo. Kolar thotë se nevojitet me ndihmën e më shumë faktorëve siç janë institucionet shtetërore, kompanitë që merren me certifkimin e prodhimtarisë organike e kështu me radhë të rritet edhe me shumë kjo veprimtari.

" Rritja e përqindjes së prodhimtarisë bujqësore që shfrytëzon metoda të qëndrueshme organike të prodhimtarisë, më nuk është zgjidhje por domosdoshmëri. Në të ardhmen vështirë se mund të prodhojmë ushqim nëse nuk përkujdesemi për truallin, ujin dhe biodiverzitetin. Andaj mbetet që gradualisht të tejkalohen problemet apo sfidat si sasitë e vogla që pamundësojnë plasmanin jashtë shtetit, rritjen e numrit të konsulentëve për prodhimtarinë organike , qasjen më të lehtë ndaj farave përkatëse e kështu me radhë", shton Kolar. Nga ana tjetër, Qeveria e Republikës së Maqedonisë përmes masave të ndryshme synon rritjen e prodhimtarisë së ushqimit. Gjithashtu, për herë të parë shpallet edhe thirrje publike për ndarjen e tokës shtetërore të dedikuar vetëm për prodhimtarinë organike. Para dy javësh nga ana e Ministrisë së Bujqësisë u promovua edhe Regjistri i ri i operatorëve organik. Përmes këtij regjistri konsumatorët kanë mundësi të marrin informata të saka për të gjithë prodhuesit, tregtaret, furnizuesit dhe përpunuesit e certifikuar të produkteve organike. Regjistri mundëson edhe kontakte direkte me zinxhirin e prodhuesve organik.

MASAT FAVORIZUESE

Nga Ministria e Bujqësisë thonë se masat që favorizojnë këtë lloj prodhimtarie përfshijnë edhe subvencionet deri me 100 për qind më të larta në raport me prodhimtarinë konvencionale. Bile është rritur edhe shuma e tyre prej 61 milionë denarë në 81 milionë denarë. Njëherazi në mjetet e pakthyeshme prej 10 mijë euro për fermerët e rinj, përparësi do të kenë ata që vendosin të merren me prodhimtari organike. Punohet edhe në promovimin e prodhimeve organike nga Maqedonia në panairet e jashtme që mundësojnë nënshkrimin e marrëveshjeve për eksport.

"Përgatisim masa të ndryshme me qëllim që të inkurajojmë fermerët e rinj që të merren me prodhimtari organike. Kështu në thirrjen e re për bujq të ri janë ndarë 4 milionë euro nga Programi për zhvillim rural. Në drejtim të rritjes së prodhimtarisë organike është edhe ndarja e tokës shtetërore deri më tre hektarë ku përparësi do të kenë prodhuesit organik", thotë ministri i Bujqësisë, Ljupço Nikollovski.

Ndryshe, sipas Ligjit për prodhimtari organike në Republikën e Maqedonisë për një hapësirë konvencionale që të bëhet organike nevojiten 2-3 vite. Dy vite janë të nevojshme për kulturat njëvjeçare, ndërsa tre për shumëvjeçaret, siç janë vreshtat dhe pemëtaria. Gjatë kësaj periudhe kohore duhet të jetë e pastruar toka nga helmet e shkaktuara nga prodhimtaria konvencionale. Qëllimi kryesor i prodhimtarisë organike është ruajtja e mjedisit, pjelloria e tokës dhe ruajtja e konsumatorëve nga efektet e ndryshme që vijnë nga pesticidet në prodhimtarinë intensive. Arritja e gjithë kësaj që përmendëm më lart mund të arrihet nëse nuk përmbushen disa parakushte që kërkohen duke filluar nga parakushti i parë që është ngastra apo vendi ku kultivohet produkti i cili duhet të jetë larg objekteve industriale, larg rrugëve që ka qarkullim të madh të makinave, gjithashtu duhet të ketë ujëra nëntokësore të cilat duhen të jenë të pastra .

EDHE MEPSO NË RRJETET E MENÇURA

RAJONI PO PËRGATITET PËR ERËN E ELEKTROMOBILAVE

Në fjalimin e tij para rreth 400 pjesëmarrësve në takim, Sasho Vasilevski, drejtori i përgjithshëm i MEPSO-s foli për projektet aktuale investuese, për hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe integrimet në nivel rajonal dhe për sfidat nga tranzicioni i elektro-transmetuesve në rrjete të mençura

Shkup, 23 tetor - Tranzicioni i elektro-transmetimeve në rrjetet e mençura është sfidë e madhe i të gjithë sistem-operatorëve elektro-transmetues. Në rajonin tonë të gjithë sistem-operatorët aktivisht përgatiten për zbatim të zgjidhjeve të cilat mes tjerash do të mundësojnë edhe përdorim masiv të automobilave elektrik. Sistem-operatorët elektro-transmetues nga rajoni ynë aktivisht përgatiten të zbatojnë zgjidhje për implementim të rrjeteve të mençura me të cilët mes tjerash do të mundësohet përdorim masiv i automobilave elektrik.

Kjo, siç njoftoi SHA MEPSO, është një nga konkluzionet e panelit në të cilin folën drejtorët e përgjithshëm të sistem-operatorëve elektro-transmetues të Republikës së Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë dhe Sllovenisë, që u mbajt dje në Sarajevë, Bosnjë e Hercegovinë. Krahas kësaj teme, aktuale ishin edhe çështjet për implementim të burimeve ripërtëritëse të energjisë elektrike dhe hapjen e tregut rajonal për energji balancuese në vendet e rajonit tonë.

Në fjalimin e tij para rreth 400 pjesëmarrësve në takim, Sasho Vasilevski, drejtori i përgjithshëm i MEPSO-s foli për projektet aktuale investuese, për hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe integrimet në nivel rajonal dhe për sfidat nga tranzicioni i elektro-transmetuesve në rrjete të mençura.

Paneli në të cilin morën pjesë njerëzit e parë të sistemeve elektro-transmetuese nga të gjithë vendet të cilët dolën nga ish RSFJ, është pjesë e takimit më të madh të inxhinierëve nga sfera e elektro-energjetikës, të cilin e organizon organizata më e madhe ndërkombëtare e inxhinierisë IEEE PES dhe sivjet mbahet në Sarajevë duke filluar nga 22 deri më 25 tetor. Në këtë takim shkencor-teknik këmbehen përvoja nga sfera të ndryshme të energjetikës dhe prezantohen përvoja për tranzicion të rrjeteve elektro-transmetuese në rrjetet e mençura.

IEEE PES është organizatë internacionale e inxhinierëve e cila është themeluar në vitin 1886 dhe në mbarë botën ka më shumë se 38.000 anëtarë midis të cilët shumë inxhinierë botëror me renome, menaxherë dhe shkencëtarë, ndërsa sivjet organizon mbi 40 konferenca në lokacione të ndryshme në mbarë botën.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (tekst i pastruar Të publikuar në Gazetën zyrtare të RM nr. 167/2015 dhe ndryshim të plotësimit të LMP numër 27/2016 dhe 120/2018), nenit 5, 6, 7 dhe 8 të Marrëveshjes kolektive të Operatorit të sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria aksionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik në pronësi të shtetit Shkup ose shkurtimisht SHA MEPSO, Shkup (nr. ark. 02-6432 të datës 31.10.2013), dhe Vendimit numër 02-7131të datës 22.10.2018 për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës, Operatori i sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria aksionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik në pronësi të shtetit Shkup ose shkurtimisht SHA MEPSO, Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës me 23 (njëzetetre) punëtorë për realizim të punëve për kohë të pacaktuar në Operatorin e sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria aksionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik në pronësi të shtetit Shkup ose shkurtimisht SHA MEPSO, Shkup.

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj, duhet të përmbushin kushtet e posaçme për plotësim të vendeve të punës në vijim:

1. 1 (një) realizues në vendin e punës referent përkthyes në Seksionin për zhvillim dhe investime, shërbimi për menaxhim me projekte, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti filologjik/gjuhë angleze, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 36.540,00 denarë
2. 1 (një) realizues në vendin e punës teknik për përpunimin e të dhënave në shërbimin për GIS dhe punë gjeodezike në Seksionin për zhvillim dhe investime, me përgatitje të mesme profesionale – PMP – shkalla IV, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 31.146,00 denarë.
3. 1 (një) realizues në vendin e punës referent për përcjellje të kredive dhe lajmërimeve kreditore në Seksionin për financa, shërbimi për kreditim të kredive ndërkombëtare, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti ekonomik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 36.540,00 denarë.
4. 1 (një) realizues në vendin e punës referent për furnizime në Seksionin për punë komerciale shërbimi për punë furnizuese komerciale, me përgatitje të lartë/të mesme profesionale PLP/PMP shkalla VII/1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VI/180-240 SETK, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 36.540,00 denarë.
5. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier përgjegjës në Seksionin për IT, shërbimi për servis biznes informativ, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti për informatikë/elektroteknik, me dy vjet përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 44.196,00 denarë.
6. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier në Seksionin për IT, shërbimi për servis biznes informativ, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti për informatikë/elektroteknik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
7. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier i pavarur në Seksionin për IT, shërbimi për servis infrastrukturor informatik, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti për informatikë/elektroteknik, me një vjet përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 41.760,00 denarë.
8. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier i pavarur në Seksionin për IT, shërbimi për sguri të rrjeteve, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti për informatikë/elektroteknik, me një vjet përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 41.760,00 denarë.
9. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier në Seksionin për telekomunikime, shërbimi për sisteme të telekomunikimit, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti për informatikë/elektroteknik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
10. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier në Seksionin për telekomunikime, shërbimi për infrastrukturë të telekomunikimit, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti për informatikë/elektroteknik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
11. 1 (një) realizues në vendin e punës referent i pavarur në Seksionin për punë juridike, shërbimi për punë juridike, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK - VIA 240 SETK – Fakulteti juridik drejtimi i jurisprudencës, me një vit përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
12. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier për mirëmbajtje elektroteknike në shërbimin për mirëmbajtje të stacioneve transformatore në Seksionin për kontroll teknik, mirëmbajtje dhe kontroll të ST, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VI 180-240 SETK – Fakulteti elektroteknik – elektroenergjetik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
13. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier për AC/DC sisteme, shërbimi për AC/DC sisteme dhe lidhje sekondare në Seksionin për kontroll teknik, mirëmbajtje dhe kontroll të ST, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VI 180-240 SETK – Fakulteti elektroteknik – elektroenergjetik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
14. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier përgjegjës për LP, departamenti për përgatitje të LP në Seksionin për largpërçues, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VIA 240 SETK – Fakulteti elektroteknik – elektroenergjetik, me dy vjet përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 44.196,00 denarë.
15. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier për largpërçues, shërbimi për mirëmbajtje të LP, në Seksionin për largpërçues, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VI 180-240 SETK – Fakulteti elektroteknik – elektroenergjetik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
16. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier përgjegjës për matje të largpërçuesve, departamenti për matje të LP në Seksionin për largpërçues, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VIA 240 SETK – Fakulteti elektroteknik – elektroenergjetik, me dy vjet përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 44.196,00 denarë.
17. 1 (një) realizues në vendin e punës udhëheqës të ST Shkup 4, shërbimi për eksploatim, në Seksionin për ST, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VIA/VII 240-300 SETK – Fakulteti elektroteknik – elektroenergjetik, me tre vjet përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 42.456,00 denarë.
18. 1 (një) realizues në vendin e punës udhëheqës i punëve në qendrën rajonale Negotinë, ST Dubrovë, shërbimi për eksploatim, në Seksionin për ST, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII/1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VI 180-240 SETK – Fakulteti elektroteknik – elektroenergjetik, me dy vjet përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
19. 1 (një) realizues në vendin e punës elektro-inxhinier për planifikim ditor (Scheduiling& Accounting & MC), shërbimi për planifikim operativ, në Seksionin për menaxhim me EES, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VIA 240 SETK – Fakulteti elektroteknik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
20. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier për analizë të rrjetit, shërbimi për planifikim operativ, në Seksionin për menaxhim me EES, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VIA 240 SETK – Fakulteti elektroteknik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
21. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier për udhëheqje dhe menaxhim të tregut të brendshëm dhe rajonal të energjisë balancuese, shërbimi për organizim dhe menaxhim të tregut të energjisë balancuese, në Seksionin për menaxhim me EES, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VIA 240 SETK – Fakulteti elektroteknik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
22. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier për SCADA aplikacione, shërbimi për SCADA/EMS, në Seksionin për informatikë teknike, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VIA 240 SETK – Fakulteti elektroteknik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.
23. 1 (një) realizues në vendin e punës inxhinier për interfejs procesues dhe lokal, shërbimi për sisteme të mbikëqyrjes dhe menaxhim me EEO, në Seksionin për informatikë teknike, me përgatitje sipërore profesionale shkalla VII /1 ose sipas kornizës nacionale për KAS/SETK – VIA 240 SETK – Fakulteti elektroteknik, pa përvojë pune, për të cilin vend pune pagesa arrin 40.020,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen, në të cilën shënohet se për cilin vend pune aplikohet, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumente e nevojshme, varësisht nga kushtet e theksuara për vendin konkret të punës për të cilin aplikojnë:

- Biografi të shkurtë (CV) dhe letër motivimi në gjuhën maqedonase
- Dëshmi për arsim të mbaruar (në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë (kopje)
- Telefon për kontakt

PËR VENDET E PUNËS NË TË CILAT THEKSOHET SE KËRKOHET PËRVOJA E PUNËS

- Dëshmi për përvojë pune, duke theksuar përvojën e punës dhe kohëzgjatjen e asaj përvoje, të dhënë nga kompania/institucioni/organi, me të cilën do të dëshmohet se personi (kandidati) me shkallë konkrete të përgatitjes profesionale ka fituar përvojë pune aftësi dhe të ngjashme (në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter) ose Listë nga SPIM (për vendet e punës për të cilat theksohet se kërkohet përvojë e punës)

Shpallja zgjatë 3 (tre) ditë pune nga dita e publikimit (duke mos llogaritur ditën e publikimit).

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet në afat prej 45/90/120 ditë pas skadimit të afatit për paraqitje varësisht nga numri i kandidatëve të paraqitur.

Marrëdhënia e punës bëhet për kohë të pacaktuar.

Java e punës zgjatë 5 ditë pune (prej ditës së hënë deri në ditën e premte), orari i plotë i punës është 40 orë në javë, me 8 orë pune në ditë, fillimi dhe mbarimi i orarit ditor të punës është prej 07.45 deri në 08.15, ndërsa largimi nga vendi i punës është prej 15.45 deri në 16.15, me të drejtë pauzë gjatë punës ditore me kohëzgjatje prej 30 minuta në periudhën prej ora 10.00 deri në ora 12.00.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit si dhe fletëparaqitjet e pakompletuara, nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Afati për dorëzim të fletëparaqitjeve dhe dokumenteve të kandidatëve të interesuar është 3 (tre) ditë pune, duke llogaritur nga dita e ardhshme e publikimit të shpalljes publike (duke mos llogaritur ditën e publikimit).

Të gjitha aplikacionet do të shqyrtohen me besim maksimal.

Për zgjedhjen e realizuar kandidatët e paraqitur do të informohen në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës nga dita e lidhjes së marrëveshjes për punësim me kandidatin e zgjedhur.

Operatori i sistemit elektropërçues të Maqedonisë, Shoqëria Aksionare për përçim të energjisë elektrike dhe menaxhim me sistemin elektroenergjetik në pronësi të shtetit Shkup ose shkurtimisht SH A MEPSO, Shkup ofron mundësi të barabarta për punësim pavarësisht gjinisë, rasës, moshës, mendimit politik, statusit martesor, fesë, përkatësisë etnike ose nacionale.

Dokumentet e nevojshme të dorëzohen në adresën e SH A MEPSO Shkup, rr. "Maksim Gorki" nr. 4 Shkup.

Drejtori gjeneral,
Sasho Vasilevsk

VAZHDOJNË PUNIMET NË KOMUNËN E TEARCËS

TROTUARE PËR SIGURINË E KËMBËSORËVE

Ndërtimi i këtyre trotuareve është bërë për të përmirësuar sigurinë e vet banorëve që kanë shtëpitë afër kësaj rruge regjionale, tha Isen Asani, kryetar i Tearcës

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 23 tetor - Aktualisht përgjatë rrugës Tetovë-Jazhincë është duke u punuar intenzivisht në rregullimin e trotuareve në fshatin Sllatinë dhe Neproshten. Gjatë rifillimit të punëve në këtë aks rrugor, Komuna e Tearcës kishte hasur në disa pengesa, të cilët janë tejkaluar dhe punët ka vazhduar gjatë dy muajve të fundit pa ndërprerë.

Ndërtimi i këtyre trotuareve është bërë për të përmirësuar sigurinë e vet banorëve që kanë shtëpitë afër kësaj rruge regjionale, tha Isen Asani, kryetar i Tearcës. "Duke patur parasysh sigurinë e banorëve në këtë pjesë të Komunës së Tearcës, ne do të vazhdojmë edhe më tej që të rregullojmë trotuare duke vazhduar deri në fshatin Neproshten, gjegjësisht deri në kufirin me Komunën e Tetovës", ta kreu i komunës së Tearcës. Tearca vitin e kaluar filloi punët ndërtimore në ndërtimin e trotuarit përgjatë rrugës Tetovë-Jazhincë, nga fshati Sllatinë drejtë fshatit Tearcë në gjatësi 2.5 kilometra dhe gjerësi 2.6 metër. Sipas kreut të kësaj komune, ky investim do të përmirësojë dukshëm lëvizjen e banorëve dhe qytetarëve të fshatrave te Komunës së Tearcës dhe është vazhdimësi e investimeve kapitale që investohen në përmirësimin e infrastrukturës rrugore nëpër të gjitha fshatrat e Komunës.

Kohë më parë, trotuar është ndërtuar edhe në fshatin Dobrosht. Banorët e fshatit Përshefcë kishin reaguar se pse nuk ndërtohet trotuarin në fshatin e tyre, ndërsa Asani thotë se edhe në këtë fshat trotuaret do të ndërtohen.

"Në agjendën tonë, prioritet e kemi trotuarin e fshatit Përshefcë dhe shumë shpejtë kjo çështje do zgjidhet. Kjo çështje për fshatin Përshefc do të jetë e kryer, nuk do lejojmë ne kështu për arsye se kërkesa është e arsyeshme dhe është pragmatike dhe ne do ti mbështesim", ka thënë kohë më parë Asani. Krahas kësaj, deri më tash, pjesa më e madhe e rrugës regjionale Tetovë-Jazhincë që kalon në Komunën e Tearcës është edhe me ndriçim publik.

"Kjo është bërë me qëllim që në këtë rrugë, krahas pamjes dhe imazhit ndryshe, po ashtu edhe gjatë natës mjaft do të ndihmojë vozitësit që të mos kenë problem kur dihet se në këtë rrugë, është i madh frekuentimi i automjeteve që lëvizin në drejtim të Jazhincës dhe jo rrallë herë janë shkaktuar aksidente", thonë në komunën e Tearcës. Përndryshe, vite me radhë rruga regjionale Tetovë-Jazhincë vazhdon që edhe më tutje të jetë në mesin e rrugëve më të rrezikshme në rrethinën e Tetovës, për shkak se në këto rrugë janë regjistruar shumë aksidente, në disa raste edhe me pasoja tragjik, gjegjësisht me të vdekur. Arsyet më e shpeshta për numrin e madh të aksidenteve është mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet e rrugës, gjegjësisht vozitja e shpejtë, mos respektimi i sinjalistikës rrugore, stërngarkimi i rrugës për shkak të rritjes së fluksit të automjeteve që qarkullojnë në këtë rrugë, sidomos në muajt e verës,por edhe për shkak të dëmtimit të rrugës në shumë pjesë të sajë. Si rezultat në këtë rrugë rajonale janë regjistruar shumë dalje nga rruga, të cilat jo rrallë herë janë shoqëruar edhe me rrokullisjen e automjeteve, ndeshje, por ka pasur raste kur kanë pësuar edhe këmbësorët, çiklistët dhe motoçiklistët. Në ndërkohë me ndërtimin e trotuareve pritet që të rritet siguria e këmbësorëve në rajonin e kësaj komune.

FILLON "SKUPI FESTIVAL"

BUXHETI I VOGËL, POR PRITJET E MËDHA

Nga sot deri më 30 tetor në Qendrën Kulturore Rinore do të mbahet edicioni i 12 i Festivalit Ndërkombëtar - Skupi Festival, në të cilën do të marrin pjesë 7 shfaqe nga po aq vende

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 23 tetor - Artdashësit nga rajoni i Shkupit, por edhe më gjerë, për shtatë mbrëmje radhazi, do të kenë mundësi të ndjekin edicionin e 12-të i Festivalit Ndërkombëtar të Taetrove –"Skupi Festival", kurse në skenë pritet të paraqiten trupat teatrore nga Kosova, Shqipëria, Serbia, Italia, Bulgaria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Rumania.

Festivali, i cili tradicionalisht mbahet për 11 vite me radhë do të zgjasë shtatë ditë, kurse artdashësit do të kenë mundësi ti përcjellin shfaqet çdo ditë me fillim prej ora 20:00 në Qendrën Kulturore Rinore. Festivalin do ta hapë Teatri Kombëtar i Kosovës me shfaqjen "Im atë e donte Adolfin", punuar sipas dramës së Mehmët Krajës, në regji të Ilir Bokshit, shfaqje kjo që ka lajtmotiv hulumtimin për dhjetë vitet e para pas Luftës së Dytë Botërore, e cila paraqet kthesë të madhe historike tek shqiptarët. Organizatorët e këtij Festivali u shprehen se janë të kënaqur me punën e deritanishme, edhe përskaj pengesave të cilat i kishin hasur gjatë organizimit, sepse është e vështirë që një festival të bëhet tradicional.

"Kishim disa kundërshtar të çuditshëm të cilët deshën të na godasin, mirëpo dita ditës ne rritemi. Viteve të fundit jemi përballur me problemin buxhetor por edhe me ish Ministrin e Kulturës, sepse ndau buxhet me të cilin ne nuk mund të vazhdonim më tej dhe për këtë kërkuam shpjegime nga ish ministri i cili nuk dha", theksoi drejtori i këtij Festivali, Muzbajdin Qamili. Ai u shpreh faleminderues ndaj të gjithëve, në veçanti Ministrin aktual të Kulturës, Asaf Ademin, i cili ka ndihmuar në realizimin e këtij festivali.

Selektori Senko Velinov theksoi se gjithmonë janë munduar që të nxisin risi nëpërmjet këtij festivali, duke sjellur teatro dhe aktorë të cilët publiku ynë nuk ka pasur mundësi që ti sheh në vendin tonë. Ndërsa Festivali edhe këtë viti e ka ruajtur traditën për të mos pasur përfaqësues nga Maqedonia. "Shpresoj dhe besoj që edhe më tutje do të vazhdojmë me traditën e këtij festivali duke i mundësuar publikut të shijojë të gjitha shfaqet dhe gjithmonë duke sjellur fytyra dhe teatro të reja. Shfaqet e teatrit tonë mund ti shohim në repertuarin e teatrove dhe nuk dëshirojmë që ato të jenë alibi për paratë e shpenzuara nga ministria, të cilat janë të pakta", tha Velinov. Festivali do të përmbyllet me shfaqjen "Robëroje Veten" nga Rumania, pas së cilës do të ndahet edhe çmimi i Festivalit.

"Skupi Festival" mbështetet nga Ministria e Kulturës, Telekomi i Maqedonisë, ndërsa sponsor medial është gazeta KOHA.

Ndarja e Evropës, Putinit mund t'i ngecë "sharra" në gozhdë

Nga
Natalie Nougayrede

Ish-kryeministri rus Viktor Çernomërdin tha dikur batutën e famshme: "Ne donim më të mirën, por ajo doli vetë si gjithmonë". Kur zyrtarët holandezë, britanikë dhe amerikanë javën e kaluar, denoncuan sulmet e koordinuara të kibernetike të Rusisë - objektivat e të cilave variojnë nga sportive organet anti-doping tek vëzhguesit ndërkombëtare të armëve kimike - u duk sikur thënia e Çernomërdin kishte një kuptim të ri. Pavarësisht të gjitha përpjekjeve që bëri Kremlini për organizimin e duhur të Kupës së Botës këtë vit, si një dëshmi e hapjes së Rusisë ndaj botës, duket se vazhdojnë të bëjnë bujë lajmet rreth gabimeve të shërbimeve të tij sekrete, në fakt jo aq të tilla.

Bellingcat, një uebsajt investigative, publikoi emrin e agjentit të dytë rus të përfshirë në helmimin e Sergeri Skripal dhe vajzës së tij. Reagimet zyrtare ruse kanë filluar nga denoncimi i një "fushate propagandistike të menaxhuar nga skena", për të sfiduar "histerinë perëndimore në lidhje me spiunët e supërfuqishëm kibernetikë rusë". Por, për një president rus që mburret për efikasitetin e vet, dhe e bën Rusinë të duket e fuqishme, të gjitha këto janë një pengesë të madhe. Madje edhe shtetet e vogla perëndimore të Europës, me asnjë histori të ndonjë përballjeje të tensionuar gjeopolitike më Rusinë, mund ta shohin veten të shënjestruara.

Si adoleshent, Putini ishte i hipnotizuar nga filmat sovjetikë me spiunë të viteve 1960. Në vitet e para të presidencës së tij, pika e tij e fortë ishte efikasiteti i tij. Një nga arsyet që ai u bë president, ishte se ai do të provonte vlefshmërinë e tij ndaj "familjes" së Jelcinit (siç ishte quajtur) gjatë drejtimit të shërbimeve sekrete të FSB-së. Agjentët e tij u urdhëruan të fusnin në një kurth seksual prokurorin e përgjithshëm rus, Juri Skuratov, në mënyrë që ta pengonin atë të hetonte marrjen e ryshfeteve nga zyrtarë të nivelit të lartë. Shumë shpejt, një videokasetë e transmetuar në televizionin shtetëror e kishte diskredituar plotësisht Skuratovin. E gjithë kjo do të thotë: konferenca për shtyp, në të cilën qeveria holandeze akuzoi agjencinë e inteligjencës ushtarake të Rusisë - GRU, se shënjestroi Organizatën për Ndalimin e Armëve Kimike, nuk përputhej saktësisht me narrativën e Putinit për një Rusi të rilindur.

Detaji më fatkeq i të gjithave ishte se një nga agjentët e GRU kishte ruajtur faturën e udhëtimit me një taksi në Moskë, çka tregonte se ai kishte udhëtuar në aeroport nga një rrugë tjetër pranë zyrave të agjencive të inteligjencës. Pavarësisht aspektit komik të kësaj ngjarje, Europa duhet të nxjerrë një mësim më të gjerë nga ajo: përçarja e nxitur nga Kremlini nuk mund të përshkruhet më së shumti si një strategji që synon mbajtjen e shteteve satelitore ish-sovjetike nën sundimin e Moskës.

Përkundrazi, përpjekjet e Rusisë për të minuar institucionet, janë tashmë të dukshme në të gjithë Evropën. Që prej shembjes së komunizmit, evropiano-lindorët kanë ndjerë shpesh se mendimet e tyre anti-ruse janë përqeshur nga evropiano-perëndimorë si histerike dhe të fiksuar pas neo-imperializmit që gjallon në Moskë. Pasi Estonia u godit nga një sulm i madh kibernetik rus në 2007 dhe disa në Paris apo Berlin shqetësoheshin se një ditë rreziku mund të shtrihej më tej në perëndim. Tani me Holandën kaq shumë të ekspozuar ndaj veprimeve ruse, është bërë gjithnjë e më e qartë se vendet e vogla edhe perëndimore evropiane me asnjë histori e konfrontimeve të tensionuara gjeopolitike me Rusinë, mund ta shohin veten në shënjestër. Mes holandezëve dhe rusëve nuk ka asnjë trashëgimi të rivalitetit mes fuqive. As Holanda nuk është një nga ato të vendeve evropiane që kanë përjetuar historikisht agresionin më të keq të Rusisë apo sovjetikëve, qoftë në Luftën e Dytë Botërore, gjatë komunizmit, apo më herët.

Ajo që i bëri holandezët një objektiv, është se ata janë përgjegjës për sigurinë e OPCW me seli në Hagë. Por holandezët nuk janë vetëm në këtë valle. Më parë gjatë këtij viti, Greqia - një vend pro-rus dhe i krishterë ortodoks, denoncoi ndërhyrjen e Rusisë në punët e saj të brendshme rreth mosmarrëveshjes mbi emrin e Maqedonisë. Ngjashëm, Emanuel Makron i Francës, ka deklaruar se Rusia kërkon të "shpërbëjë BE-në" - një deklaratë e habitshme nga udhëheqësi i një vendi, që tradicionalisht ka provuar të ketë një marrëdhënieje të veçantë me Moskën, që nga koha e Sharl De Golit. Disa analistë në Berlin e zbulojnë gjithashtu një ton më të ashpër në qasjen e Gjermanisë ndaj Rusisë - me një fokus të ri në mbajtjen më afër të Evropës Qendrore, në vend se të përpiqet të bashkëpunojë me ngushtë me Moskën. Agjentët rusë të kapur në Hagë, kishin plane për të kryer operacione të mëtejshme, kundër një laboratori në Zvicrën neutrale - vështirë se një vend mund të pretendojë të jetë pjesë e nënshtrimit të supozuar të NATO-s nga Rusia. Kur vjen puna te kuptimi i qëllimeve të Putinit, linja e ndarjes së vjetër europiane Lindje-Perëndim, po bëhet e parëndësishme.

> **Është e mundur që evropiano-perëndimorët të ndjejnë një afërsi të re me polakët dhe baltikët që e kanë paralajmëruar prej kohësh Brukselin mbi shkeljet e Rusisë, por që ndjenin (sidomos para luftës në Ukrainë) se ishin si një zë i vetmuar në shkretëtirë**

Ajo që ka të ngjarë të bëhet më e spikatur, është një model të cilin Kremlini ka qenë i angazhuar për ta kultivuar:simpatitë ideologjike, që dalin nga populistët e ekstremit të djathtë në të gjithë Evropën, si në lindje (Viktor Orban i Hungarisë), ashtu edhe në perëndim (Mateo Salvini i Italisë). Hija e gjatë e ndarjes lindje-perëndim, nuk do të zhduket brenda natës: lindorët që jetonin në perëndimin e robëruar, siç e përshkroi dikur shkrimtari Milan Kundera bllokun sovjetik, kanë kujtime që të tjerët nuk i kanë. Më së paku, kriza e refugjatëve e vitit 2015, e bëri më të dukshëm hendekun lindje-perëndim. Por, siç më tha një zyrtar i nivelit të lartë gjerman këtë javë, veprimet e Rusisë mund të japin një nxitje për unitetin evropian, në vend se të thellojnë mosmarrëveshjet. Tani është e mundur që evropiano-perëndimorët të ndjejnë një afërsi të re me polakët dhe baltikët që e kanë paralajmëruar prej kohësh Brukselin mbi shkeljet e Rusisë, por që ndjenin (sidomos para luftës në Ukrainë) se ishin si një zë i vetmuar në shkretëtirë. Në fund, aksionet ruse mund të ndihmojnë në mbylljen e disa hendeqeve në empatinë evropiane. Ky nuk është një film me spiunë që do t'i pëlqente Putinit.

(The Guardian)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 22 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | **MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222** | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Ndryshimet kushtetuese për palën greke! Po për shqiptarët?

Nga
Dr. Argëtim SALIU

Është thënë e shkruar edhe më parë se, përvoja më se 27-të vjeçare e zbatimit të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (edhe me plotësimet e vitit 2001, që rrjedhin nga Marrëveshja e Ohrit), ka treguar se, Kushtetuta është një dokument i hartuar jo mirë dhe në përgjithësi nuk u është përgjigjur pozitivisht nevojave të shoqërisë shqiptare në këtë periudhë të vështirë tranzicioni.

Madje, kërkesat e papërfillura të shqiptarëve nga viti 1991 deri në vitin 2001, sollën deri te kryengritja e shqiptarëve, me qëllim të avancimit dhe institucionalizimit të lirive dhe të drejtave të tyre në shtetin e uzurpuar nga bashkëqytetarët maqedonas. Nga ky këndvështrim është e kuptueshme që nga disa forca politike, nga disa juristë dhe profesorë universitarë, që janë marrë posaçërisht

> Deputetët shqiptarë në Kuvendin e Maqedonisë, detyrimisht duhet të shfrytëzojnë nga momenti i ndryshimeve kushtetuese për zyrtarizimin e gjuhës shqipe në Kushtetutën e re

me të drejtën kushtetuese dhe administrative, të jenë formuluar vërejtje për nene të veçanta të saj. Në të gjitha situatat e krijuara, personalitete të ndryshëm të vendit kanë apeluar, kanë kërkuar madje edhe janë angazhuar konkretisht duke ofruar ndihma profesionale, që të intervenohet në Kushtetutë me qëllim që të eliminohen të gjitha padrejtësitë institucionale ndaj populit shqiptar në Maqedoni. Iniciativa e fundit për ndryshime kushtetuese si rrjedhojë e arritjes së Marrëveshjes së Prespës në mes të Maqedonisë dhe Greqisë, imponon nevojën si asnjëherë më parë që, si popull, të jemi më këmbëngulës në ndryshimet kushtetuese që tangojnë lirinë dhe të drejtat tona të natyrshme, sepse, jo gjithmonë vijnë situatat dhe rrethanat e këtilla kaq të volitshme! Si asnjëherë më parë, sot duhet të jemi më këmbëngulës në kërkesën gjithëpopullore për t'u intervenuar, për shembull, në nenin shtatë, paragrafin e parë dhe të dytë të Kushtetutës, ku shënon se gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik është gjuha zyrtare në Maqedoni, të vazhdohet me: и албанскиот јазик со неговото латинско писмо / dhe gjuha shqipe me shkrimin e vet latin.

Ndonëse ka zëra dhe mendime se tani nuk është koha për ndryshime të tjera kushtetuese, për shkak të një procesi më të "rëndësishëm" se përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe, e ajo është zgjidhja e kontestit të emrit dhe anëtarësimi i vendit në NATO, megjithatë, nuk duhet anashkaluar nevoja dhe kërkesa e popullit shqiptarë që një herë e përgjithmonë të zgjidhet çështja e zyrtarizimit të gjuhës shqipe me Kushtetutë, sepse nëpërmjet sjelljes së ligjit për gjuhët është bërë vetëm avancimi i përdorimit të gjuhës shqipe dhe jo edhe zyrtarizimi kushtetues i saj.

Një shtet bashkëkohor demokratik, në rrjedhën natyrore të zhvillimit dhe krijimit të vet, duhet vazhdimisht të sigurojë Kushtetutën e vet që tërësisht t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të saj, në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare si dhe vet të zhvillohet vazhdimisht. Ndryshe, çdo intervenim apo përmirësim në tekstin e kushtetutës së një vendi, nëse nuk plotësojnë kërkesat e natyrshme të një komunitetit, për të mos thënë të një etnie, atëherë ato do të jenë vetëm makijazh i përkohshëm i cili nuk garanton asgjë të mirë e të bukur! Maqedonia duhet të radhitet krah atyre shteteve të cilat shekuj më parë kanë hartuar kushtetuta të përshtatshme dhe të pranueshme për çdo kohë, rrethanë dhe për të gjithë qytetarët e vet, pa kurrfarë nuancash diskriminimi. Askush nuk e ka tagrin që të tallet me kushtetutën, si themel i një shteti.

Italia po kthehet në rrezik

Nga
Bernd Riegert

Koalicioni i përbërë nga populistët dhe radikalët e djathtë në Romë po bën gjithçka për ta çuar Italinë më shpejt se mendohej buzë greminës. Që t'i paraqesësh BE një buxhet borxhesh që shkel rregullat është një provokim i ndërgjegjshëm. Lëvizja "5 yjet" dhe Lega duan të tregojnë se janë burokratët e këqij të Brukselit ata që duan t'i vënë vargonj "qeverisë së kthesës". Por hipoteza se Italia mund të përballojë vitin e ardhshëm shpenzime që kalojnë kufijtë dhe të ulë njëkohësisht me rritje më të lartë ekonomike kuotën e borxhit shtetëror është krejt aventureske.

Populistët duan ta bëjnë Italinë të pavarur nga tregjet financiare. Për këtë italianët duhet të blejnë edhe më tepër hua të shtetit të tyre. Shteti do ta shpërblejë këtë me ulje taksash. Kjo do të sillte më pak të ardhura në taksa dhe do ta rriste edhe më shumë hendekun midis të ardhurave dhe shpenzimeve.

Por plani i mirëfilltë, i përcaktuar edhe në marrëveshjen e koalicionit midis populistëve dhe radikalëve të djathtë është: të futet

në përdorim një monedhë paralele. Me to shteti do të paguante borxhet e tij ndaj firmave italiane. Firmat mund të paguanin me to borxhet në tatime përballë shtetit. Shumica e ekonomistëve paralajmërojnë me forcë që të mos bëhen eksperimente të tilla. Në hapësirën e Euros një monedhë e tillë do të ishte gjithsesi ilegale, por kjo nuk i intereson Salvinit dhe Di Maios.

Bashkimi Evropian duhet të reagojë me vendosmëri ndaj provokimit dhe ndaj lojës tepër të rrezikshme të populistëve, por edhe me takt. Vetëm në dialog mund të eliminohen mëkatet më të këqija nga projektbuxheti italian. Fjalët e ashpra nga ana e BE dhe refuzimi padyshim i justifikuar i projektbuxhetit vetëm do t'u ofronin populistëve një pretekst të mirëpritur për t'i damkosur evropianë për

> Projektbuxheti i papërballueshëm i qeverisë italiane të përbërë nga populistët dhe radikalët e djathtë e detyron BE të ecë drejt vendimeve delikate. Fjala është për besueshmërinë e BE dhe për tepër shumë para

të gjitha ato që do të ecin ters në Itali muajt e ardhshëm. Po të mos heqin dorë populistët nga projektligji i tyre i rrezikshëm, BE duhet të reagojë në mënyrë konsekuente dhe të synojë çeljen e ndjekjes penale. Çështja është nëse do t'i përulej asaj Italia. Nëse mosmarrëveshja për buxhetin nuk do të zgjidhet shpejt, BE ecën drejt një krize, përballë së cilës Brexiti mund të dukej si vogëlsi. (DW)

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

LIGJET NUK FUNKSIONOJNË PËR TË PUSHTETSHMIT E POLITIKËS

Aktualisht, në Qeverinë e Kosovës janë 7 ministra të cilët janë duke u përballur me procedura gjyqësore për vepra të ndryshme penale, kryesisht të korrupsionit.

Kodi i ri penal dhe Kodi i ri i procedurës penale, pritet që të futen për zbatim vitin e ardhshëm, thonë zyrtarë të Kuvendit të Kosovës, por për sa i përket sanksionimeve të veprave penale kundër detyrës zyrtare, nuk pritet të ketë ndryshime të mëdha në krahasim me kodet aktuale penale dhe të procedurës penale, vlerësojnë njohësit e çështjeve juridike.

Sami Kurteshi, anëtar i Komisionit parlamentar për legjislacion, mandate, rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsion, thotë për Radion Evropa e Lirë se Kodi penal me ndryshimet e propozuara nga ekzekutivi, është shqyrtuar nga grupi punues dhe pritet që ta shqyrtojë edhe Komisioni. Por, sipas tij, në Kodin penal nuk janë parë ndryshime të mëdha, ndërkohë që Kodi i ri i procedurës penale ende nuk i është proceduar Komisionit për legjislacion.

"Ne nuk i dimë cilat janë ndryshimet që do të propozohen nga Ministria (e Drejtësisë) në Kodin e Procedurës Penale. Ç'është e vërteta edhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, Komisioni, do të thotë, ne si deputetë, kurrë nuk i kemi marrë të gjitha ndryshimet, së bashku, që i ka propozuar Ministria, që t'i dinim se çka është kërkuar që të ndryshohet. Ka munguar transparenca në atë drejtim, mirëpo është punuar i tërë Kodi", tha Kurteshi.

Profesori i të Drejtës Penale Ndërkombëtare, Ismet Salihu, i cili duke folur për Radio Evropa e Lirë, ka thënë se ishte pjesë e ekipit që ka punuar në Kodin e ri Penal, thotë se në këtë Kod janë bërë ndryshime dhe plotësime, përfshirë edhe për veprat penale kundër detyrës zyrtare.

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 dhe 161 nga ligji për mbrojte shëndetësore (gazeta publike e Republikës së Maqedonisë nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15,17/16, dhe 37/16), neni 22 dhe neni 23 nga ligji për marrëdhëniet e punës (gazeta publike e Republikës së Maqedonisë nr. 74 nga data 08.05.2015), pajtimi për punësim nga ministria e financave nr. 18-2860/2 nga data 08.03.2018, vendimi për botimin e shpalljes publike nr. 04-378/1 nga data 19.10.2018, e miratuar nga UD drejtori i IPSH Qendra për shëndet publik - Prilep publikon

SHPALLJE PUBLIKE

për punësim të punëtorëve me orar të pacaktuar

1. IPSH Qendra për shëndet publik Prilep ka nevojë për punësimin e:

- **Doktor i medicinës me orar të pacaktuar - 2 (dy) realizues**

2. Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara nga ligji i mbrojtjes shëndetësore
- të jetë shtetas i RM
- të jetë i moshës madhore
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
-te mos ketë të shqiptuar ndalesë efektive për kryerjen e profesionit, veprimtarive ose detyrave

3. Përveç se t'i ketë kushtet e përgjithshme të vërtetuara, kandidati duhet ti plotësojë **kushtet e veçanta** në vijim

- arsim të lartë të mbaruar me më se paku 240 kredi të fituar sipas SETK ose VII/1 shkallë të mbaruar - fakulteti i mjekësisë
- provim profesional të dhënë
- licencë për punë
- me dhe pa përvojë pune

4. Orari i punës përmban 40 orë në javë, 8 orë pune në ditë, nga 07:30 deri ora 15:30.

5. Neto rroga fillestare për doktor të medicinës është 27.227,00 denarë.

6. Në bashkëngjitje të fletëparaqitjes kandidatët janë të detyruar t'i dorëzojnë dokumentet në vijim
- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- biografi e shkurtër (CV)
- vërtetim për njohuri te gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht)
- vërtetim për shtetësi të Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje e vërtetuar në noter
- vërtetim mjekësor jo më e vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje e vërtetuar në noter
- vërtetim që nuk ka të shqiptuar asnjë ndalesë efektive për kryerjen e profesionit, veprimtarive ose detyrave, origjinal ose kopje e vërtetuar në noter
- vërtetim - diplomë për fakultet të mbaruar të mjekësisë, origjinal ose kopje e vërtetuar në noter
- vërtetim për provim profesional të dhënë, origjinal ose kopje e vërtetuar në noter
- licencë për punë, origjinal ose kopje e vërtetuar në noter.

7. Afati i shpalljes publike është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit

8. Dokumentacioni i dorëzuar me vonesë, jo i plotë ose jo i rregulluar nuk do të jetë lëndë për shqyrtim nga ana e komisionit për zgjedhjen e kandidatëve.

9. Pas përzgjedhjes së kandidatëve për doktor të medicinës të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike, do të mbahet provimi kualifikues sipas nenit 160 nga ligji për mbrojtje shëndetësore.

10. Fletëparaqitja me dokumentacionin e plotë dhe numër për kontakt, të dorëzohen në IPSH Qendra për shëndet publik - Prilep, rr. Oktomvriska pn, përmes postës ose në arkivin e IPSH Qendra për shëndet publik - Prilep, me caktim për shpalljen publike për punësim.

IPSH Qendra për shëndet publik Prilep

ЦЕНТР @ЛЕН РЕГИСТАР НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

SHKUP
Numër, 04-2043/2
22.10.2018

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr 167/2015- teksti i pastruar, 27/2016 dhe 120/2018) dhe neni 5, 6 dhe 7 nga Marrëveshja kolektive e Regjistrit qendror të RM numër 01-866/1 të datës 01.06.2018 dhe nenit 24 paragrafi 1 pika 2 e Statutit të Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë" nr 45/2007 dhe 208/2015), ndërsa në lidhje me Vendimin për nevojën e themelimit të marrëdhënies së punës numër 04-2043/1 të datës 22.10.2018, Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë shpall:

SHPALLJE PUBLIKE

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë ka nevojë për të themeluar marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar me 4 (katër) realizues për vendet e punës në vijim me kushte të veçanta edhe atë:

- 1 (një) realizues me arsim të mbaruar Shkencat Juridike ose Ekonomike me së paku 180 kredi sipas EKTS apo të mbaruar shkallën VII/1 të përgatitjes profesionale ne ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Punëtor profesional I në RRK Shkup dhe pagesa themelore 32.064,00 denarë;

- 2 (dy) realizues me arsim të mesëm gjimnaz të mbaruar ose arsim të mesëm profesional dhe me ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Referent për regjistrim në RRK Shkup dhe pagesa themelore 25.948,00 denarë;

- 1 (një) realizues me arsim të mesëm gjimnaz të mbaruar ose arsim të mesëm profesional dhe me ose pa përvojë pune në profesion, për vendin e punës Referent për regjistrim në RK Kërçovë dhe pagesa themelore 22.817,00 denarë;

Kandidati i cili do të paraqitet në Shpalljen publike, duhet ti plotësojë kushtet në vijim:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në mënyrë aktive të njohë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës së rritur;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesa për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

- Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë të punës, me orar javor të rregullt të punës prej 40 orëve (5 pesë ditë pune në javë)
- Orari ditor i punës zgjatë 8 orë dhe fillon prej orës 8,00 dhe përfundon në ora 16,00.

Bashkë me fletëparaqitjen kandidatët duhet ti dorëzojnë edhe dokumentet në vijim (kopje):
- Lutje me biografi të shkurtër (CV);
- Certifikatë shtetësie;
- Kopje të letërnjoftimit;
- Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës (Certifikatë mjekësore);
- Dëshmi që me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesa për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë (Diplomë) për arsimin e mbaruar;
- Vërtetim për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë zyre;
- Vërtetim për njohje aktive të një prej tre gjuhëve botërore që përdoren më së shpeshti të Unionit evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht);
- Dëshmi për përvojën e punës së nevojshme (dëshmohet me Vërtetim nga APRM apo Fond për SPIM) dhe institucionit në të cilën ka punuar kandidati.

Kandidatët e interesuar, lutjen së bashku me dëshmitë për plotësim të kushteve sipas kësaj shpallje mund ti dorëzojnë në afat prej 5 (pesë) ditëve të punës nga dita e publikimit të shpalljes, drejtpërdrejtë në arkivin e Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë, bul. Kuzman Josifovski Pitu nr. 1 ose përmes postës. Telefoni për kontakt 3 288 146, personi për kontakt Andrijana Anastasovska Kitanova.

Regjistrit qendror të Republikës së Maqedonisë zgjedhjen do ta kryen në afat prej 45 (dyzetepesë) ditë pune pas kalimit të afatit për paraqitje, ndërsa nëse ka më shumë se 200 të paraqitur zgjedhja do të bëhet në pajtim me afatet e caktuara ligjore.

Lutjet e dorëzuara të pakompletuara dhe pas afatit nuk do të merren parasysh.

Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë Shkup

Në bazë të nenit 4 dhe 5 nga vendimi për fillimin e procedurës për marrje me qira të hapësirave afariste për nevojat e komunës Kumanovë nr. 09-4416/12 prej datës 27.07.2018 (lajmëtari zyrtar i komunës së Kumanovës nr. 10 nga 31.07.2018) dhe mbi bazë të vendimit të kryetarit të komunës Kumanovë nr. 08-5081/2, komisioni për zbatimin e procedurës e marrjes me qira të hapësirave afariste për nevojat e komunës Kumanovë, publikon

SHPALLJE
për nevojë për marrje me qira të hapësirës afariste për nevojat e komunës së Kumanovës

LËNDA E SHPALLJES

Lënda e shpalljes është marrja me qira të hapësirës afariste për nevojat e komunës së Kumanovës për periudhë më së paku 2 (dy) vjet me të drejtë primare pas skadimit të marrëveshjes, me hapësirë prej 250 m2 deri 300 m2, i pajisur plotësisht me mobile zyre dhe ngrohje funksionale dhe klimë, që gjendet në territorin e komunës së Kumanovës, me një distancë deri më 300 metra largësi nga selia e komunës së Kumanovës, rr. 11 Oktomvri pn.

KRITERET PËR PËERZGJEDHJEN E OFRUESIT

Kriteret për përzgjedhje për ofruesin më të favorshëm do të jetë çmimi më i ultë i ofruar për qira mujore për metër në katror pa TVSH. Nëse dy ose më shumë ofertues kanë ofruar të njëjtin çmim, atëherë prioritet do të ketë oferta e dorëzuar e para.

TË DREJTA PËR PJESËMARRJE

Të drejtë në pjesëmarrje në procedurë kanë të gjithë personat fizik dhe juridik vendas dhe të huaj, pronarë të hapësirave afariste, me listën e pronës në të cilën është shënuar hapësira e ofruar, për qellim hapesire afariste e cila do te mund të përdoret për nevoja të punëve zyrtare.

AFATET

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve për pjesëmarrje është 10 dite nga dita e publikimit, në adresën e komunës së Kumanovës rr. 11 Oktomvri pn, 1300 Kumanove. Dorëzimi i aplikimeve bëhet në arkivin e komunës së Kumanovës më së voni në ora 12.00

GARANCIA E OFERTËS

Shuma e garancisë se ofertës është 1.000 EURO ne ekuivalent në denarë sipas kursit te BPRM -se në ditën e dorëzimit te ofertës.

Shuma në emër të garancisë së ofertës paguhet me virman ose përmes postës se buxhetit të RM, BPRM, Llogaria trezore 1 000 000 000 63095, llogaria e përdoruesit buxhetor 741014052563018, shifra e të ardhurave 725939 dhe programi 00 me shënim "garancia për ofertën e shpalljes për marrje me qira lokal afarist për nevojat e komunës se Kumanovës.

Në qoftë se në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditë pune pas marrjes së njoftimit për ofertën më të favorshme të ankandit publik, do të konsiderohet që ofertuesi me i favorshëm e ka tërhequr ofertën, fondet e depozituara në emër të garancisë për pjesëmarrje nuk do t'i kthehen.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË PROCES DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME

Dorëzimi i dokumenteve të duhura për pjesëmarrje bëhet në arkivin e komunës së Kumanovës. Dokumentet e dorëzuara deri në datën dhe orën e hapjes së tyre do te ruhen në arkiv. Të njëjtat dorëzohen në zarf të mbyllur me shënimin **„MOS HAP„** me shënim **"sipas shpalljes për marrje me qira të hapësirës afariste për nevojat e komunës së Kumanovës".**

Dokumentet e duhura për pjesëmarrje në procesin për marrjen me qira të hapësirës afariste për nevojat e komunës së Kumanovës janë si në vijim:

- fletëparaqitje për pjesëmarrje në të cilën do të jenë të dhënat për personin fizik/juridik pronari i hapësirës afariste, lokacioni i hapësirës afariste dhe shuma e çmimit për qira për metër katror.

- lista e pronës si vërtetim për pronësinë e hapësirës afariste e cila duhet të dorëzohet origjinal dhe nuk duhet të jetë më e vjetër se një muaj, e llogaritur deri ne ditën e paraqitjes për pjesëmarrje

- vërtetim për shumën e paguar prej 1.000 EURO me vlerë denarë, sipas kursit të BPRM-së në ditën e dorëzimit të ofertës në emër garancia e ofertës

-adresa, kontakt telefoni

- kopje e dokumentit për llogarinë transakcionale ose xhiro llogarisë në të cilën do të kthehet garancia për pjesëmarrjen. Garancia për pjesëmarrje ju kthehet pjesëmarrësve , në afat prej 7 ditësh pas mbarimit të procesit.

MËNYRA DHE PROCEDURA E ZGJEDHJES SË OFERTËS MË TË VOLITSHME

Fletëparaqitjet e arritura hapen nga Komisioni. Komisioni e kontrollon se a janë komplet dhe të parashtruar në kohën e përmendur në shpallje dokumentet. Komisioni, pas kontrollit të dokumentacionit do të bëjë këqyrjen e hapësirave të ofruara afariste që të vërtetojë se vallë hapësirat e ofruara afariste i plotësojnë kushtet e parapara në Shpallje. Ata që nuk kanë parashtruar oferta komplete dhe me kohë përjashtohen nga procedura dhe për të njëjtën gjë njoftohen. Tre kandidatët që do të ofrojnë çmim më të ulët të qirasë për metër katror do të zgjidhen si të kualifikuar dhe të njëjtit nga Komisioni do t'i propozohen Kryetarit të Komunës së Kumanovës, i cili do ta bëjë zgjedhjen e ofertës më të volitshme. Kryetari i Komunës së Kumanovës do ta bëjë zgjedhjen e ofertës më të volitshme nga radhët a ofertave të kualifikuara të dhëna si propozim. Procedura do të zbatohet edhe nëse në shpallje konkurrojnë më pak se 3 oferta, gjegjësisht nëse ka vetëm një pjesëmarrës që i plotëson kushtet e dhëna në shpallje.

Në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve të punës nga pranimi i njoftimit me shkrim për zgjedhje të ofertës më të volitshme, ofertuesi më i volitshëm është i obliguar që të nënshkruaj Kontratë për qira me Kryetarin e Komunës së Kumanovës. Ofertuesi më i volitshëm e ka për obligim që të sigurojë posedim të drejtpërdrejtë të hapësirës afariste për Komunën e Kumanovës në afat prej më së shumti 5 (pesë) ditë pas nënshkrimit të Kontratës për qira, për çka do të përpilohet edhe procesverbal për pranim – dorëzim.

Komisioni për zbatim të procedurës
për marrje me qira të hapësirës afariste për
nevojat e Komunës së Kumanovës

REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E KUMANOVËS

Sektori për urbanizëm, veprime komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës

21-4212/9
10.2018

Në bazë të nenit 35 paragrafi 3 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15 ,31/16, 163/16 dhe 64/18), nenit 50 paragrafi 1 pika 4 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02) dhe nenit 25 paragrafi 1 pika 7 e Statutit të Komunës së Kumanovës ("Fleta Zyrtare e Komunës së Kumanovës" nr. 13/03, 13/07 dhe 8/15), Kryetari i Komunës së Kumanovës jep lajmërimin në vijim:

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës publike dhe Prezantimit publik në lidhje me

1. Propozim-plan të detajuar urbanistik për pjesën nga Nj.U "Treta MUB" pjesë nga Blloku urban 48 pjesa 2 dhe për pjesën nga Nj.U B. S Gojço pjesa nga BU 44, përfshirje planore mes rr. "Treta MUB", rr. "Pero Çiço", rr. "Prva Petolerka" dhe rr. "Mile Kipra" – Komuna e Kumanovës, përfshirja planore me sipërfaqe prej 3,24 ha.
2. Propozim-plan të detajuar urbanistik për pjesën nga Nj.U "Industria" pjesë e Bllokut urban 83 përfshirje planore mes kufirit të rajonit ndërtimor, kufiri i Nj.U, rr. "Oktomvriska Revolucija", rruga rajonale R-2133, PK 9700– Komuna e Kumanovës, përfshirja planore me sipërfaqe prej 81813,67 m2.
3. Propozim-plan të detajuar urbanistik për pjesën nga Nj.U "Goce Dellçev" pjesë nga Urban blloku 29, përfshirja planore mes rr. "AVNOJ" , rr. "Mirçe Acev", rr. "Rajko Zhinzifov", "Strasho Pinxhur" dhe rr. "222"- Komuna e Kumanovës, përfshirja planore me sipërfaqe prej 38169,64 m2.
4. Propozim-ndryshim dhe plotësim të Planit të detajuar urbanistik për pjesën prej Nj. U B. S Gojço pjesë nga BU 44 modul G, PN 13 të PK 20449/1, PK 20449 dhe PK 26297/5 përfshirja plore në rr. "Lupço Arsov" – Komuna e Kumanovës, përfshirja planore me sipërfaqe prej 575,76 m2.

Anketa publike dhe Prezantimi publik me Propozim PDU-ve do të realizohet me ekspozimin e Propozim PDU-ve në sirtaret e Komunës në Sheshin e qytetit, që gjenden te ish "Tutun" – Kumanovë.

Anketa publike do **të zgjasë 10 ditë pune** duke filluar prej më **29.10.2018 deri më 09.11.2018.**

Për kohëzgjatjen e anketës publike subjektet e interesuara fizike dhe juridike informacione më të detajuara mund të marrin në Komunën e Kumanovës, Sektori për urbanizëm, veprimtari komunale dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe natyrës.

Gjatë anketës publike propozime ose vërejtje të tyre mund të parashtrojnë të gjithë subjetet e interesuara fizike dhe juridike në listat anketuese.

PREZANTIMI PUBLIK

Më **datë 01.11.2018 në ora 12^{00}**, në sallën e takimeve në Komunën e Kumanovës organizohet Prezantim publik me prezantimin profesional të

1. Propozim-plan të detajuar urbanistik për pjesën nga Nj.U "Treta MUB" pjesë nga Blloku urban 48 pjesa 2 dhe për pjesën nga Nj.U B. S Gojço pjesa nga BU 44, përfshirje planore mes rr. "Treta MUB", rr. "Pero Çiço", rr. "Prva Petolerka" dhe rr. "Mile Kipra" – Komuna e Kumanovës, përfshirja planore me sipërfaqe prej 3,24 ha.

2. Propozim-plan të detajuar urbanistik për pjesën nga Nj.U "Industria" pjesë e Bllokut urban 83 përfshirje planore mes kufirit të rajonit ndërtimor, kufiri i Nj.U, rr. "Oktomvriska Revolucija", rruga rajonale R-2133, PK 9700– Komuna e Kumanovës, përfshirja planore me sipërfaqe prej 81813,67 m2.

3. Propozim-plan të detajuar urbanistik për pjesën nga Nj.U "Goce Dellçev" pjesë nga Urban blloku 29, përfshirja planore mes rr. "AVNOJ" , rr. "Mirçe Acev", rr. "Rajko Zhinzifov", "Strasho Pinxhur" dhe rr. "222"- Komuna e Kumanovës, përfshirja planore me sipërfaqe prej 38169,64 m2.

4. Propozim-ndryshim dhe plotësim të Planit të detajuar urbanistik për pjesën prej Nj. U B. S Gojço pjesë nga BU 44 modul G, PN 13 të PK 20449/1, PK 20449 dhe PK 26297/5 përfshirja plore në rr. "Lupço Arsov" – Komuna e Kumanovës, përfshirja planore me sipërfaqe prej 575,76 m2.

Kryetari i Komunës
Maksim Dimitrievski

LIGA E KAMPIONËVE

SUPERSFIDA BARCELONA - INTER

"Kemi pasur një nisje të mirë në Champions League dhe duhet të fitojmë që të vazhdojmë këtë rrugë që kemi nisur. Fitorja me Barcelonën është e rëndësishme për ne edhe në aspektin psikologjik", u shpreh Icardi

Nga ana tjetër Mungesa e Messit për tre javë, pas dëmtimit që mori në krahë kundër Seviljes, duket se ka entuziazmuar Interin, që tashmë e shohin fitoren si një opsion të mundshëm. Zikaltërtit do të përballen me katalanasit të mërkurën mbrëma, ndeshje e vlefshme për Champions League dhe sipas kapitenit, Mauro Icardi, mungesa e tij është një goditje e madhe për Barcelonën që do të ndikojë edhe në lojën e tyre. Interi dhe Barcelona kanë fituar dy ndeshjet e para të këtij sezoni në "Champions League", dhe do të përpiqen që të bëjnë të njëjtën gjë edhe në përballjen e nesërme dhe shanset për italianët janë më të mëdha, duke qenë se gjigantëve të La Ligës u mungon kapiteni. "Është një fatkeqësi që Messi nuk mund të luajë sepse diçka e mirë që të luash kundër futbollistëve të mrekullueshëm si ai, i cili është ndër më të mirën në botë. Ai është një mungesë e madhe dhe kjo do të thotë se mund të përballemi me ta sepse ne i kemi kualitete e duhura për t'u ndeshur me ta. Kemi pasur një nisje të mirë në Champions League dhe duhet të fitojmë që të vazhdojmë këtë rrugë që kemi nisur. Fitorja me Barcelonën është e rëndësishme për ne edhe në aspektin psikologjik", u shpreh Icardi. Nga ana tjetër, Interi ka konfirmuar se Radja Nainggolan mund të mungojë për disa javë pas lëndimit që pësoi në ndeshjen ndaj Milanit të dielën. Mesfushori belg lëndoi kyçin e këmbës së majtë pas një përplasje me Lucas Biglian në fitoren 1 me 0 të Interit. Tani Interi ka konfirmuar se testet kanë treguar se ai ka ndrydhur nyjën dhe gjendja e lojtarit do të rivlerësohet në javët në vijim, duke sugjeruar se ai do të mungojë në mesjavë ndaj Barcelonës në Ligën e Kampionëve, të paktën.

BARCELONA-INTER: SHIFRA DHE KURIOZITETE NGA SUPERSFIDA

Inter kërkon suksesin në shtëpinë e Barcelonës, një ekip që ngjall kujtime të ëmbla te zikaltrit, pas përballjes së dyfishtë të sezonit 2009-2010, ku ata fituan akses në finalen e Ligës së Kampionëve, pastaj e fituan atë. Ja disa shifra dhe kuriozitete nga përballjet mes këtyre skuadrave. Barcelona ka fituar tri nga gjashtë ndeshjet e mëparshme kundër Interit në Ligën e Kampionëve. Humbja e vetme erdhi në ndeshjen e parë, në edicionin 2009-2010 (1-3). Barcelona ka arritur sukses në katër nga pesë ndeshjet e mëparshme në shtëpi, kundër Interit, në garat europiane, duke përfshirë tri ndeshje në Ligën e Kampionëve, pa pësuar gol. Humbja e vetme në shtëpi daton nga janari i vitit 1970, në "Coppa delle Fiere" (1-2). Skuadra katalanase është e pamposhtur në 13 ndeshje të luajtura në shtëpi të Ligës së Kampionëve, kundër kundërshtarëve italianë. Fitorja e fundit italiane në shtëpinë e blaugranëve në këtë kompeticion daton në prill 2003 (1-2, kundër Juventusit). Barcelona ka fituar 25 nga 27 ndeshjet e fundit në Ligën e Kampionëve, duke shënuar 85 gola dhe pësuar 13 të tillë. Më së shumti në një ndeshje ka pësuar në humbjen e majit 2013, kundër Bayern Munich (3-0). Ndryshe, Interi ka arritur sukses në dy ndeshjet e para të këtij edicioni të Ligës së Kampionëve. Vetëm në sezonin 2004-2005, zikaltrit i fitonin tri ndeshjet e para në Champions. Lionel Messi shënoi 65 gola në 65 ndeshje të Ligës së Kampionëve me fanellën e Barcelonës në "Camp Nou". Messi shënoi në secilën prej nëntë paraqitjeve të fundit si startues në fazën e grupit (17 gola). Lojtari i Barcelonës, Lionel Messi, ka shënuar 10 gola në shtatë ndeshjet e fundit të Ligës së Kampionëve kundër kundërshtarëve italianë: çdo herë që e gjeti rrugën e rrjetës në "Camp Nou", kundër skuadrave italiane, ai shënoi dy herë. Lionel Messi shënoi pesë gola për Barcelonën në Ligën e Kampionëve, këtë sezon, më shumë se ato të realizuar nga 27 skuadra të ndryshme, deri më tani, duke përfshirë Interin (katër).

LIVERPOLI NDAJ CRVENA ZVEZDËN, SHAQIRI: E DI QË DO TË VËRSHËLLEHEM, POR SPORTI NUK DUHET TË POLITIZOHET

Liverpool do të jetë nikoqir i skuadrës serbe të Crvena Zvezdës. Skuadra angleze do të mirëpres gjatë ditës së mërkure në Anfield Road ekipin beogradas në kuadër të xhiros së tretë të Ligës së Kampionëve. Kjo do të thotë që mesfushori shqiptar i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri do të takohet për herë të dytë gjatë një periudhë kaq të shkurtër me një skuadër serbe. Para disa muajve sulmuesi shqiptar ishte një realizator i golit të fitores (2-1) së kombëtares zvicerane kundër Serbisë në kuadër të kampionatit botëror, ku Shaqa kishte festuar duke formuar me duar simbolin e shqiponjës. E duke marrë parasysh se shumë polemika ishin ngritur pas festimit, para takimit ka folur Xherdani për mediat duke thënë se nuk duhet përzier sportin me politikën. "Do të jetë një ndeshje si çdo tjetër. Në fund, kjo është vetëm një lojë futbolli. Është e rëndësishme dhe duam të fitojmë, por sporti nuk është politikë. Ndoshta do të ketë prej atyre që do të më vërshëllejnë, por për mua është pothuajse si çdo takim tjetër", tha Shaqiri. Ndryshe, takimi mes këtyre dyja ekipeve do të duhet të zhvillohet në ora 21:00, ku The Reds konsiderohen favoritë absolut. Ndërkaq, në takimin mes PSG dhe Napolit sipas informacioneve të Yahoo Sport, te ekipi francez pritet të mungojë Thiago Silva. Media thotë se braziliani ka pësuar një dëmtim në kavilje, dhe gjithashtu ka një shqetësim muskulor. 34-vjeçari thuhet të ketë folur me Tuchel dhe të dy kanë rënë dakord që ai ta bëjë pushim mesjavën. Trajneri gjerman me shumë mundësi do të aktivizojë dyshen Marquinhos-Kimpembe në qendër të mbrojtjes. Ndërkohë do të rikthehen në formacion Thomas Meunier dhe Neymar, që e bënë pushim në ndeshjen e fundjavës ndaj Amiens. Në përballjet tjera do të takohen. Club Brugge pret Monacon, PSV do të jetë nikoqire e Tottehamit, Dortmund në shtëpi pret Atletico Madridin, Galatasaray takohet me Schalken dhe Lokomotiv Moswow do të luaj ndaj Portos.

Conte kërkon pagë vjetore prej 10 milionë eurove te Reali

Kampi i Antonio Contes është njoftuar tashmë për interesimin e presidentit të Real Madridit, Florentino Perez. Conte u kontaktua të hënën e kaluar nga ndërmjetësuesit Realit për zëvendësimin e Julen Lopetegui, shkruan e përditshmja italiane Corriere dello Sport. Kjo e fundit shkruar se zyrtarët madrilen kanë telefonuar agjentin e trajnerit italian, Federico Pastorello pas humbjes gjatë fundjavës së kaluar kundër Levantes. Italianët raportojnë Conte do të kërkon që të paguhet afërsisht sa ishte duke drejtuar skuadrën angleze të Chelseat. Italiani kërkon 10 milionë euro për të kaluar në Madrid, i cili tejkalon pagën e Lopeteguit prej gjashtë milionë eurosh. Antonio ende nuk e ka zgjidhur problemin e kontratës me londinezët që e shkarkuan gjatë verës pas dështimit në vitin e kaluar. Ndryshe, Reali po kalon nëpër një krizë të rezultateve të dobëta ku në pesë ndeshjet e fundit nuk ka shijuar fitore.

Publicitet

SHPALLJE PUBLIKE
(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 nga LP e publikuar ne shpalljen publike te RM, nr. 72 nga 12.04.2016)

Përmbaruesi Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizimin e përmbarimit nga kreditori Shoqëria për shërbime intelektuale dhe tregëti, e bazuar në dokumentin përmbarues NPN.nr. 312/2017 i Noterit Bashkim Elezi nga Gostivari, kundër shoqeriës për punësim të personave me invaliditet ndërtimtari tregëti dhe shërbime XHIMI-KO DOOEL eksport- import Gostivar, me lëndë të regjistruar përmbaruese nën P.nr. 088/2018 më 18.10.2018

I THËRRET

Bashkëpronarët e pasurive të patundëshme të regjistruar në listen e pronave nr. 56683 per KO Shkup 2 edhe atë :

- Gjorgjov Ane Nikola me adresë në bul. J. Sandanski 35/1/10, Shkup
- Adamoska- Klisaroska Snezhana me adresë Nikola Trimpare 7/5, Shkup
-Ali Osman Sevinç me adresë në rr. Todor Aleksandrov nr. 83/2/6, Shkup
- Angel Iliev me adresë ne rr. Petar Drapshin 6C, Shkup,
- Aneta Gjorgjievska me adresë në rr. Sava Kovaçeviq 7/5 Shkup,
- Blagoja Zafirovski me adresë Kozle 174, Shkup
- Buçkov Dario me adresë në rr. Koce Metalec 4/1/7, Shkup,
- Goran Toshevski me adresë Franklin Ruzvelt 38, Shkup
- Dean Taleski me adresë në rr. Vladimir Komarov nr.13/23, Shkup
- Dogazanska Marija me adresë në rr. Rilski Kongres nr.103A, Shkup
- SHOQËRIA PËR NXERRJE TË GURIT, TRËGETI DHE PRODHIM PROGRES 1998 DOOEL import-eksport f. Vrutok Gostivar
- SHOQËRIA PËR NDËRTIMTARI, INZHINJERING, TREGETI, PROMET DHE SHERBIME NOV DOM INVEST DOOEL Shkup, me adresë Ivo Ribar Lola nr. 149/12, Shkup,
- SHOQËRIA PËR NDËRTIMTARI, PROEKTIME, INZHINIERING, TREGËTI DHE SHËRBIME ZSF-KOM -SHOQËRIA PËR PRODHIM, TREGËTI DHE SHËRBIME IVANOV INZHINJERING SASHKO IVANOV DOOEL MANASTIR me adresë Boris Kidriç 12/16, Manastir,
- Zafirovska Gjurgjena me adresë Kozle 174, Shkup,
-Zafirovski Kiro me adresë Kozle 174, Shkup,
-Ilkovski Mario rr. Dramska nr.8, Shkup
-Irena Gjorgjievska me adresë Hristo Tatarçev 7/5, Shkup
-Kosta Topuzoski me adresë Todor Aleksandrov 83/1/4, Shkup
- Kostandina Çalmoska Popovska, me adresë Kole Nedelkovski 15 A, Shkup-Çair,
- Mirjana Topuzoska, me adresë Todor Aleksandrov 83/1/4/, Shkup,
-Savevski Sasho me adresë Predrag Jançievski 36, Tetovë
-Sevinç Ali Osman R. e Gjermanisë
- Tomiq Tomislav bul. Partizanski Odredi 153/1/60/ Shkup,
- SHOQATA TREGTARE PËR NDËRTIMTARI, TRËGETI DHE SHERBIME EUROPROFIL DOOEL, IMPORT-EKSPORT me adresë Nikola Vapcarov 2/1/1, Shkup
-Tugjarova Gjorgova Smilja bul. Jane Sandanski 35/1/10, Shkup

të vijnë në zyrën e përmbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari në rr. Zhivko Brajkovski nr. 23 për dorëzimin e :

Konklузion për një shitje të dytë publike gojore nga 18.10.2018 P. nr. 088/2018 i përmbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari, në afat prej 2 (dy) ditësh nga data e publikimit në gazetat ditore Nova Makedonija dhe Koha, për qëllim të realizimit të drejtës ligjore për blerje primare.

PËRMBARUESI
Aleksandar Kuzmanovski

DASHI 21. mars - 20. prill

Marrja e një roli drejtues do ju vijë natyrshëm, për shkak se ju prireni të jeni disi autoritar. Kjo e martë favorizon një klimë paqësore dhe mjaft të favorshme, ku sforcimet do të jenë minimale.

DEMI 21. prill - 21. maj

Vlerësoni më së miri të gjitha ndryshimet e pësuara gjatë këtyre ditëve. Do të reflektoni thellësisht dhe kjo gjë do ju lejojë që të mos bini pre e provokimeve të tepërta.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Parashikohet një ditë e cila do ju gjejë protagonistë, për shkak të një periudhe të mbushur me shumë të reja interesante, si nga pikëpamja profesionale edhe ajo sentimentale. Takimet janë mjaft të favorshme.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Mos u përfshini nga paniku, për shkak të zërave që qarkullojnë, pasi në këtë moment nuk mund ti lejoni vetes që të bini në grackën e personave ziliqarë për suksesin tuaj profesional. Në dashuri parashikohet një mbrëmjen e rëndësishme për të sqaruar një keqkuptim.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Shfrytëzoni më mirë fuqinë tuaj për të mbyllur të gjitha çështjet që gjatë javëve të fundit ju kanë tensionuar. Mbrëmja është mjaft e rëndësishme për të rigjetur qetësinë dhe për të gjetur bashkëpunimin dhe harmoninë në çift.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Në vendin e punës duhet të jeni shumë të përqendruar, pasi gjatë kësaj të marte do të përballeni në një diskutim mjaft të komplikuar sa i takon realizimit të një projekti të ri. Takime mjaft interesante parashikohen gjatë pasdites.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Kjo e martë është mjaft e rëndësishme për të bërë paqe me gjithë ata persona, të cilët gjatë javëve të fundit ju kanë tensionuar. Dialogu është mjaft i favorshëm, ndaj mund të gjeni një kompromis të vlefshëm.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Dita do të sjellë mundësi të shumta, për të mbyllur negociata me vlerë. Ky është momenti i duhur për të rifituar siguri nga pikëpamja sentimentale, ku jeni përfshirë në një lidhje të turbullt.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Nga pikëpamja sentimentale parashikohen zhvillime mjaft interesante, pasi gjatë muajve të fundit keni pësuar zhgënjime të mëdha, shkruan noa.al. Bëni kujdes ndaj ndonjë keqkuptimi në vendin e punës. Këshillohet që të mos jeni shumë kokëfortë.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Duhet të tregoheni më të zgjuar dhe më të matur lidhur me bashkëpunëtorët tuaj, sidomos nëse ata do të shfaqen shumë kokëfortë dhe aspak tolerantë. Në këtë moment është e rëndësishme që të jeni të përqendruar maksimalisht, në mënyrë që të arrini zgjidhje interesante të cilat do ju lejojnë arritjen e objektivave tuaja.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Parashikohet një javë mjaft e ngjeshur dhe impenjative, sa i takon sferës profesionale. Këshillohet që të jeni më kurajoz dhe intuitiv dhe kjo gjë do ju bëjë të pazëvendësueshëm në realizimin e një projekti të ri.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do të shfaqni një sjellje mjaft pozitive, sa i takon sferës së ndjenjave dhe kjo gjë edhe në sajë të rigjetjes së bashkëpunimit me partnerin/en. Gjatë javëve të fundit e keni lënë familjen pas dore, ndaj ka ardhur momenti që të rikuperoni.

Mensur Mamuti	SHKENCËTARI GJERMAN NË FOTO	PËRURIM	KRAHINË GJERMANE, VENDLINDJA E SHKENCËTARIT NË FOTO	FUTBOLLISTI KAMERUNIAN, SEMJUEL	GJUETAR TINGASH (LLOJ PESHKU)
RAJONET, ANËT					
KRYENEÇËSIA					
PËRKUL, KTHEN DIÇKA					
FILOZOFI ÇEK, JAN				GAUSI / SUNDIMTAR I EGJIPTIT TË LASHTË	
UNI					
HËNOR / POLITIKANI KANADEZ, VIRK					
A					LLOJ KARROCE TË VOGËL
6 ROMAK			ASTATI / I PROVUAR		
JO E KEQJA					
BELGJIKA / KODËR AFËR TETOVËS (ZHELINË)		SHPIKJA E SHKENCËTARIT NË FOTO / KRATER NË HËNË			
J					
KËNGËTARJA AMERIKANE, DAJANA				RAJON NË KUFIRIN E EVROPËS DHE AZISË / TRAJTA E EMRIT	
KOHA	VEND NË ITALI / FABRIKA E AUTOMJETEVE E PRIBOJIT				VESHJE KOMBËTARE INDIANE / AKTORI AMERIKAN, SPENSER
LLOJ PEME					BIMË BARISHTORE PARAZITARE / TEATRI NDËRKOMBËTAR
AUSTRIA		AKTORJA DANEZE, NILSEN / ANGSTREMI			
NDËRMERR MASA PËR NDALIMIN E NJË TË KEQE					



GYPI I GJAKUT	MATEMATIKANI GJERMAN, FRIDRIH, BASHKËSHPIKËSI I SHKENCËTARIT NË FOTO	RUMANIA	LLOJ LIKERI ITALIAN	SPECIALIST I NJË SHKENCE NATYRORE (SHIH FOTON)
		NOTË MUZIKORE / STACION, PROGRAM TELEVIZIV		
VESHJE KOMBËTARE INDIANE / AKTORI AMERIKAN, SPENSER				
	PËREMËR VETOR / SHKRONJA E PARË			

ZGJIDHJET: VISET, INATI, LAKON, HUS, G, EGOJA, LUNAR, AMRIK, VI, AT, E MIRA, B, TELEGRAF, JEREBINA, MI, ROS, KAUKAZ, STRA, SARI, FTUA, BINEK, A, ASTA, ATA, PARANDALON.

Sudoku

mesatar

					9			
9		2				7		8
4		3		7		6		9
			4		8			5
		6				1		
1			3		2			
6		4		9		3		1
3		1				8		6
			1					

shumë i lehtë

6						3		
			5	4				
	5		8		1			
7						9		
					7		1	4
		9				2	7	
3		1					5	
				7	2	1		8
		7			8			

Shumë i lehtë: 618729345, 973546821, 452831697, 725413986, 836297514, 149685273, 381964752, 594372168, 267158439. **Mesatar:** 517689432, 962543718, 483271659, 739418265, 826957143, 145362987, 674895321, 351724896, 298136574.

INSTAGRAMI, RRJETI SOCIAL MË I DËMSHËM PËR SHËNDETIN MENDOR

Instagrami duket një vend miqësor, një platformë fotografish, ku postimet me suksesin më të madh arrihen falë pozitivitetit që përçojnë, e ku të gjithë dukemi të gëzuar dhe pa stres. Një festë kolektive, ku merr pjesë edhe një numër i lartë profilesh dedikuar qenve dhe maceve, pak a shumë të famshëm. Çfarë mund të shkojë keq vallë në botën e lumtur të Instagramit? E megjithatë, kur në vitin 2017 revista prestigjioze "Royal Society for Public Health" drejtoi një sondazh mbi përdorimin e rrjeteve sociale nga të rinjtë, u zbulua që pikërisht platforma dedikuar fotografisë ishte ajo, që më shumë sesa të tjerat përkeqësonte cilësinë e jetës së përdoruesve të saj.

Kundër çdo parashikimi, Instagrami është vendosur në vend të fundit, duke marrë pikë veçanërisht negative për sa i përket perceptimit për vetveten, cilësisë së gjumit, e sindromës së re "FOMO" (frikës ndaj humbjes së diçkaje me rëndësi, si arsyeja kryesore e shpërdorimit pa kufij të kohës në rrjetet sociale). Një numër i madh ekspertësh të shëndetit mendor rakordojnë në tezën se Instagrami shkakton në përdoruesit e tij ndjesi sikleti dhe parehatie, pikërisht prej "pozitivitetit" ekstrem që rrezaton.

Nga një këndvështrim i caktuar, të qëndrosh në Instagram është si të shohësh televizion pa arritur të dallosh publicitetin; me ekspozime familjesh perfekte, burra dhe gra suksesi, udhëtime përrallore shumë larg realitetit të përditshëm, etj. Gjithsesi, të gjithë kontribuojmë në ruajtjen e parehatisë që shpërndan Instagrami, duke publikuar aspektet më pozitive dhe më të fotografueshme të jetës sonë. Në këtë mënyrë, Instagrami transformohet në një konkurs hiperambicioz, me popullaritet të gjerë, të matshëm me precizion ekstrem, përmes treguesve si numri i ndjekësve ose pëlqimet e marra.

Mbesa e Mussolinit: Do të padis ata që ofendojnë gjyshin tim

Shpërthejnë polemikat në Itali pas deklaratës së europarlamentares Alesandra Musolini. Kjo e fundit, mbesë e Musolinit, deklaroi se do të denonconte këdo që ofendon gjyshin e saj në rrjetet sociale. Me anë të një mesazhi në Tuiter, europarlamentarja Alessandra Mussolini ka paralajmëruar se një ekip avokatësh kanë nisur punën për të verifikuar nëse dikush ka ofenduar nëpër rrjetet sociale gjyshin e saj Benito Musolini. Ajo u shpreh se ka nisur monitorimi dhe nëse do të ketë raste ofendimesh apo sharjesh, autori i tyre do të denoncohet. Kaq ka mjaftuar dhe në Itali kanë shpërthyer polemikat, pro dhe kundër saj. Në këtë mënyrë politikania është detyruar të sqarojë se do të sinjalizohen ata që përdorin fjalë vulgare duke mos shprehur gjykime politike apo historike. Apologjia e fashizmit dënohet me ligjin Skelba të 1952-shit, dhe parashikon sanksione penale për këdo që bën propagandë ndonjë shoqatë. Lëvizje apo grupi me karakteristika fashiste. Por dhe ata që lavdërojnë përfaqësuesit e lartë të kësaj ideologjie, në këtë rast Benito Musolini.

Jetëgjatësia në Kinë do të kalojë mbi 80 vjeç

Mosha mesatare e jetëgjatësisë në Kinë do të kalojë mbi 80 vjeç deri në vitin 2040. Sipas gazetës China Daily, mësohet se revista mjekësore The Lancet ka kryer një studim mbi moshën e jetëgjatësisë të 195 vendeve nga viti 2016 deri në vitin 2040.

Në studimin e kryer parashikohet se jetëgjatësia mesatare do të jetë mbi 80 vjeç në 59 vende duke përfshirë edhe Kinën deri në vitin 2040, ndërsa gjithashtu theksohet se do të rriten vdekjet nga aksidentet dhe sëmundjet si Alzheimer dhe ato të mëlçisë. Teksa bëhet e ditur se jetëgjatësia do të jetë mbi 85 vjeç në vendet si Japonia, Singapori, Spanja dhe Zvicra, pritet që deri në vitin 2040 të ketë ndryshime në renditjen e jetëgjatësisë aktuale të vendeve.

Kina e cila aktualisht ndodhet në vendin e 68-të nga pikëpamja e mesatares aktuale të jetëgjatësisë, bëhet e ditur se ajo do të rritet duke u renditur në vendin e 39-të, ndërsa SHBA-ja e cila ndodhet në vendin e 43-të do të ketë një rënie duke vajtur në vendin e 64-të. Bashkë me këtë theksohet se deri në vitin 2040 do të ketë përmirësime edhe në kohën e jetëgjatësisë të shumë vendeve, si dhe parashikohet që mesatarja e jetëgjatësisë në vendet e Republikës së Afrikës Qendrore dhe vendet afrikane si Somali dhe Zimbabve do të ulet nën moshën 65 vjeç.

KALENDARI HISTORIK 24 TETOR

1492 - 24 hebrenj digjen në turmë drush në Mecklenburg të Gjermanisë.

1648 - Njihet pavarësia e Zvicrës.

1656 - Traktati i Vilniusit: Rusia dhe Polonia nënshkruajnë marrëveshje kundër Suedisë. 1851 - William Lassell zbulon Ariel dhe Umbriel, satelitët e Uranit.

1931 - Gangsteri Al Capone dënohet me 11 vjet burg për fshehje të tatimeve.

1935 - Italia pushton Etiopinë.

1946 - Holanda dhe Indonezia nënshkruajnë armëpushim.

1973 - John Lennon paditë qeverinë amerikane se FBI përgjon telefonin e tij.

1984 - Steffi Graf luan lojën e saj të parë si profesioniste.

2003 - Concorde bën fluturimin e tij të fundit komercial.

A E DINI SE...

FËMIJËT KANË NEVOJË PËR MIKROBE!

Fëmijët kanë nevojë për mikrobe. Studimet tregojnë se mikrobet janë të rëndësishme, pasi në të kundërt fëmijët nuk mund të kenë imunitet. Ekspertët theksojnë se ky ekzagjerim në pastërti kontribuon në një sërë kushtesh kronike që variojnë nga alergjitë në obezitet. Ata bëjnë thirrje që të vegjlit të lihen të lirë, të njohin natyrën me të gjitha papastërtitë e saj. "Ne lindim pa mikrobe. Dhe në këtë moment imuniteti ynë nuk është ende i ndërtuar dhe as i zhvilluar. Në momentin që mikrobet bëhen pjesë e organizmit tonë, edhe imuniteti nis punën e tij. Pa mikrobet, sistemi ynë imunitar nuk mund të luftojë kundër infeksioneve", shprehen ekspertët

BARSOLETA

Naimi 4-vjeç

Profesori pyet nxënësin:

- Ç farë ka ndodhur në vitin 1846?

-Ka lindur Naim Frashëri

- Po në vitin 1950, çfarw ka ndodhur?

- Naim Frashëri u bë 4 vjeç!

THËNIA E DITËS

Sa më pak persona që e dinë se je i lumtur, aq më shumë zgjat lumturia. **(Ismail Kadare)**